



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.193

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 027 datë 11.12.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Paris 2001..... 10429
Ligj nr.10 028 datë 11.12.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen ndërkombëtare për ullirin dhe vajin e ullirit” 10443
Ligj nr.10 030 datë 11.12.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara” 10465
Ligj nr.10 044 datë 24.12.2008	Për ratifikimin e protokollit shtesë të “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Themeletar të Gjendjes Civile në Shqipëri” 10472

LIGJ
Nr.10 027, datë 11.12.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR MBROJTJEN E
TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE, PARIS 2001

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, bërë në Paris më 2 nëntor 2001.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5978, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

KONVENTË
MBI MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE
UNESCO
Paris, 2 nëntor 2001

Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara;

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, që u mbledh në Paris nga 15 tetori deri më 3 nëntor 2001, në sesionin e saj të 31-të,

duke njohur rëndësinë e trashëgimisë kulturore nënujore si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të njerëzimit dhe një element veçanërisht i rëndësishëm në historinë e popujve, kombeve dhe marrëdhënieve të tyre me njëri-tjetrin në lidhje me trashëgiminë e tyre të përbashkët;

e ndërgjegjshme për rëndësinë e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore nënujore dhe që përgjegjësia për këtë u takon të gjitha shteteve;

duke vënë re interesin publik dhe vlerësimin publik në rritje të trashëgimisë kulturore nënujore;

e bindur për rëndësinë e kërkimit, informimit dhe arsimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore;

e bindur për të drejtën e publikut të gëzojë përfitimet edukative dhe çlodhëse të aksesit të përgjegjshëm paqësor në trashëgiminë kulturore nënujore *in situ* dhe të vlerës së edukimit publik për të kontribuar në ndërgjegjësimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e kësaj trashëgimie;

e ndërgjegjshme për faktin që trashëgimia kulturore nënujore kërcënohet nga aktivitetet e paautorizuara drejtuar asaj dhe për nevojën për masa më të forta për t'i parandaluar këto aktivitete;

e ndërgjegjshme për nevojën për t'iu kundërpërgjigjur rregullisht ndikimit të mundshëm negativ mbi trashëgiminë kulturore nënujore të aktiviteteve legjitime që mund të ndikojnë rastësisht mbi të;

e shqetësuar thellë nga shfrytëzimi tregtar në rritje i trashëgimisë kulturore nënujore dhe veçanërisht nga aktivitetet që synojnë shitjen, përfitim ose këmbimin e trashëgimisë kulturore nënujore;

e ndërgjegjshme për praninë e teknologjisë së përparuar që lehtëson zbulimin dhe aksesin te trashëgimia kulturore nënujore;

duke besuar që bashkëpunimi ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare, institucioneve shkencore, organizatave profesionale, arkeologëve, zhytësve, palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë është thelbësor për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore;

duke marrë në konsideratë që studimi, zbulimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore kërkojnë praninë dhe zbatimin e metodave shkencore dhe përdorimin e teknikave dhe pajisjeve të përshtatshme, si dhe një shkallë të lartë të specializimit profesional, ku të gjitha tregojnë nevojën për kritere rregulluese të unifikuara;

duke ditur nevojën për të kodifikuar dhe gradualisht zhvilluar rregulla në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore në pajtim me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e UNESCO-s mbi mjetet e ndalimit dhe shmangien e importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë kulturore të datës 14 nëntor 1970, konventën e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore të datës 16 nëntor 1972 dhe konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit të datës 10 dhjetor 1982;

e angazhuar për të përmirësuar efektivitetin e masave të niveleve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për ruajtjen *in situ* ose, nëse është e nevojshme për qëllime shkencore ose mbrojtëse, rikuperimin e kujdesshëm të trashëgimisë kulturore nënujore;

pas vendimit të sesionit të njëzet e nëntë që kjo çështje duhet të bëhet objekt i një konvente ndërkombëtare,

miraton në këtë ditë të dytë të nëntorit 2001 këtë Konventë.

Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e Konventës:

1.a) “Trashëgimia kulturore nënujore” nënkupton të gjitha gjurmët e ekzistencës njerëzore që kanë një karakter kulturor, historik ose arkeologjik që kanë qenë pjesërisht ose plotësisht nën ujë, periodikisht ose vazhdimisht, për të paktën 100 vjet, si:

i) vendet, strukturat, ndërtesat, veglat e punës dhe mbetjet njerëzore, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror;

ii) anijet, avionët ose mjete të tjera, ose pjesë të tyre, ngarkesa e tyre ose përmbajtje të tjera, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror; dhe

iii) objektet e karakterit parahistorik.

b) Tubacionet dhe kabllot e vendosura në shtratin detar nuk konsiderohen si trashëgimi kulturore nënujore.

c) Instalimet e ndryshme nga tubacionet dhe kabllot, të vendosura në shtratin detar dhe që vazhdojnë të përdoren, nuk konsiderohen trashëgimi kulturore nënujore.

2.a) “Shtetet palë” nënkupton shtetet që kanë rënë dakord t’i nënshtrohen kësaj Konvente dhe për të cilët kjo Konventë është në fuqi.

b) Kjo Konventë zbatohet *mutatis mutandis* në ato territore që përmenden në nenin 26, paragrafi 2(b), që bëhen palë në këtë Konventë në pajtim me kushtet e parashikuara në atë paragraf dhe në masën që “Shtetet palë” u referohet atyre territoreve.

3. “UNESCO” nënkupton Organizatën Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara.

4. “Drejtor i Përgjithshëm” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s.

5. “Zona” nënkupton shtratin detar dhe fundin e oqeanit dhe nëntokën e tyre, tej kufijve të juridiksionit kombëtar.

6. “Aktivitetet me objekt trashëgiminë kulturore nënujore” nënkupton aktivitetet që kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor dhe që, drejtpërdrejt ose jo, cenojnë fizikisht ose ndryshe dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

7. “Aktivitetet që ndikojnë rastësisht mbi trashëgiminë kulturore nënujore” nënkupton aktivitetet që, pavarësisht se nuk e kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor ose një prej objekteve të tyre, mund të cenojnë fizikisht ose ndryshe dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

8. “Anije dhe avionë shtetërorë” nënkupton luftanijet dhe anije të tjera ose avionë që kanë qenë në pronësi ose operuar nga një shtet dhe që, në momentin e fundosjes, përdorshin vetëm për qëllime qeveritare jotregtare, që janë identifikuar si të tilla dhe përmbushin përkufizimin e trashëgimisë kulturore nënujore.

9. “Rregullat” nënkupton rregullat në lidhje me aktivitetet me objekt trashëgiminë kulturore nënujore, siç përmendet në nenin 33 të kësaj Konvente.

Neni 2

Objektiva dhe parime të përgjithshme

1. Kjo Konventë synon të forcojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.
2. Shtetet Palë bashkëpunojnë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.
3. Shtetet Palë ruajnë trashëgiminë kulturore nënujore në të mirë të njerëzimit në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente.
4. Shtetet Palë, individualisht ose së bashku sipas rastit, marrin të gjitha masat e përshtatshme, në pajtim me këtë Konventë dhe të drejtën ndërkombëtare, që janë të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, duke përdorur për këtë qëllim mjetet më të mira praktike që disponojnë dhe në pajtim me aftësitë e tyre.
5. Ruajtja *in situ* e trashëgimisë kulturore nënujore konsiderohet si opsioni i parë para lejimit ose përfshirjes në çdo aktivitet të drejtuar të kësaj trashëgimi.
6. Trashëgimia kulturore nënujore e përfutur depozitohet, konservohet dhe menaxhohet në një mënyrë që siguron ruajtjen e saj afatgjatë.
7. Trashëgimia kulturore nënujore nuk shfrytëzohet për arsye tregtare.
8. Në pajtim me praktikën e shtetit dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur ndryshon rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe praktikën e shtetit në lidhje me imunitetet e sovranitetit, as dhe të drejtat e shtetit në lidhje me mjetet e lundrimit dhe të fluturimit të shtetit.
9. Shtetet Palë sigurojnë që mbetjeve njerëzore, të cilat gjenden në ujërat detare t'u kushtohet respekti i duhur.
10. Hyrja e përgjegjshme pa dëmtuar ose dokumentimi *in situ* i trashëgimisë kulturore nënujore inkurajohet për të krijuar ndërgjegjësimin, vlerësimin dhe mbrojtjen nga publiku të trashëgimisë, përveç rasteve kur ky mundësim është në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.
11. Asnjë veprim ose aktivitet i ndërmarrë mbi bazën e kësaj Konvente nuk përbën shkak për të pretenduar, kundërshtuar ose ankumuar ndonjë pretendim për sovranitet ose juridiksion kombëtar.

Neni 3

Raporti ndërmjet kësaj Konvente dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit

Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat, juridiksionin dhe detyrat e shteteve sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit. Kjo Konventë interpretohet dhe zbatohet në kontekstin dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

Neni 4

Raporti me të drejtën e shpëtimit dhe të drejtën e gjetjeve

Çdo aktivitet, në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore ku zbatohet kjo Konventë, nuk i nënshtrohet së drejtës së shpëtimit ose së drejtës së gjetjeve, përveçse kur:

- a) është i autorizuar nga autoritetet kompetente;
- b) është në pajtim të plotë me Konventën; dhe
- c) siguron që përfuturi i trashëgimisë kulturore nënujore arrin mbrojtjen e tij maksimale.

Neni 5

Aktivitetet që rastësisht ndikojnë trashëgiminë kulturore nënujore

Secili Shtet Palë përdor mjetet më të mira praktike që disponon për të parandaluar ose lehtësuar ndikimet negative që mund të lindin nga aktivitetet nën juridiksionin e tij, që ndikojnë rastësisht në trashëgiminë kulturore nënujore.

Neni 6

Marrëveshjet dypalëshe, rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe

1. Shtetet Palë inkurajohen të hyjnë në marrëveshje dypalëshe, rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe ose të zhvillojnë marrëveshjet ekzistuese, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore. Të gjitha këto marrëveshje janë në pajtim të plotë me dispozitat e kësaj Konvente dhe nuk dobësojnë karakterin e saj ndërkombëtar. Shtetet, në këto marrëveshje, mund të miratojnë rregulla dhe rregullore që do të siguronin një mbrojtje më të mirë të trashëgimisë kulturore nënujore se ato të miratuara në këtë Konventë.

2. Palët në këto marrëveshje dypalëshe rajonale dhe marrëveshje të tjera shumëpalëshe mund të ftojnë shtetet me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, në trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse të futen në këto marrëveshje.

3. Kjo Konventë nuk ndryshon të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Palë në lidhje me mbrojtjen e mjeteve të fundosura të lundrimit, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe të lidhura para miratimit të saj, dhe veçanërisht, ato që janë në pajtim me qëllimin e kësaj Konvente.

Neni 7

Trashëgimia kulturore nënujore në ujërat e brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial

1. Shtetet Palë, në ushtrim të sovranitetit të tyre, kanë të drejtën ekskluzive të rregullojnë dhe autorizojnë aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në ujërat e tyre të brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial.

2. Pa cenuar marrëveshjet e tjera ndërkombëtare dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Shtetet Palë kërkojnë që rregullat të zbatohen për aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në ujërat e tyre të brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial.

3. Brenda ujërave të tyre arkipelage dhe detit territorial, në ushtrim të sovranitetit të tyre dhe në njohje të praktikës së përgjithshme ndërmjet shteteve, Shtetet Palë, me qëllim bashkëpunimin për metodat më të mira për mbrojtjen e mjeteve të lundrimit dhe fluturimit të shteteve, duhet të njoftojë Shtetin e flamurit Palë në këtë Konventë dhe, sipas rastit, shtetet e tjera me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, në lidhje me zbulimin e këtij mjeti lundrimi ose fluturimi të identifikueshëm të shtetit.

Neni 8

Trashëgimia kulturore nënujore në zonën e afërt

Pa cenuar dhe përveç neneve 9 dhe 10 dhe në pajtim me nenin 303, paragrafi 2 i konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, Shtetet Palë mund t'i rregullojnë dhe autorizojnë aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore brenda zonës së tyre të afërt. Për ta bërë këtë, ata kërkojnë që të zbatohen rregullat.

Neni 9

Raportimi dhe njoftimi në zonën ekskluzive ekonomike dhe në shelfin kontinental

1. Të gjitha Shtetet Palë kanë përgjegjësi për të ruajtur trashëgiminë kulturore nënujore në zonën ekonomike ekskluzive dhe në shelfin kontinental në pajtim me këtë Konventë.

Për pasojë:

a) një Shtet Palë mund të kërkojë që nëse një shtetas i tij ose një mjet lundrimi me flamurin e tij, zbulon ose synon të përfshihet në aktivitete të drejtuara në trashëgiminë kulturore nënujore që ndodhet në zonën e tij ekskluzive ekonomike ose në shelfin e tij kontinental, shtetasi ose kapiteni i mjetit lundrues duhet t'ia raportojë atij këtë zbulim ose aktivitet;

b) në zonën ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental të një Shteti tjetër Palë:

i) Shtetet Palë kërkojnë që shtetasi ose kapiteni i mjetit lundrues ta raportojë këtë zbulim ose aktivitet tek ata dhe tek ai Shtet tjetër Palë;

ii) nga ana tjetër, një Shtet Palë i kërkon shtetasit ose kapitenit të mjetit lundrues ta raportojë këtë zbulim ose aktivitet dhe të sigurojë transmetimin e shpejtë dhe efektiv të këtyre raporteve te Shtetet e tjera Palë.

2. Me depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë deklaron mënyrën në të cilën raportet do të transmetohen sipas paragrafit 1(b) të këtij neni.

3. Një Shtet Palë njofton Drejtorin e Përgjithshëm për zbulimet ose aktivitetet e raportuara atij, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Drejtori i Përgjithshëm u ofron menjëherë të gjitha Shteteve Palë çdo informacion që i njoftohet atij, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Çdo Shtet Palë mund t'i deklarojë Shtetit Palë në zonën ekskluzive ekonomike ose në shelfin kontinental të të cilit gjendet trashëgimia kulturore nënujore, interesin e tij për t'u konsultuar si të sigurojë mbrojtjen efektive të asaj trashëgimie kulturore nënujore. Një deklaram i tillë bazohet në një lidhje të verifikueshme, veçanërisht në një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, ndaj trashëgimisë kulturore nënujore përkatëse.

Neni 10

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore në zonën ekskluzive ekonomike dhe në shelfin kontinental

1. Nuk jepet asnjë autorizim për një aktivitet drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që gjendet në zonën ekskluzive ekonomike ose në shelfin kontinental, përveçse në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Një Shtet Palë në zonën ekonomike ekskluzive të të cilit ose në shelfin kontinental të të cilit gjendet trashëgimia kulturore nënujore ka të drejtën të ndalojë ose autorizojë çdo aktivitet që drejtohet ndaj kësaj trashëgimie për të parandaluar ndërhyrjen te të drejtat ose juridiksionin e tij sovran sipas parashikimit nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit.

3. Nëse ka një zbulim të trashëgimisë kulturore nënujore ose synohet që ai aktivitet do të drejtohet ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në një zonë ekonomike ekskluzive të një Shteti Palë ose në shelfin e tij kontinental, ai Shtet Palë:

a) konsultohet me të gjitha Shtetet e tjera Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 9, paragrafi 5, si të mbrohet më mirë trashëgimia kulturore nënujore;

b) bashkërendon këto konsultime si "Shteti bashkërendues", përveçse kur ai deklaron shprehimisht që nuk dëshiron ta bëjë këtë, dhe në këtë rast Shtetet Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 9, paragrafi 5 emërojnë një shtet bashkërendues.

4. Pa cenuar detyrën e të gjitha Shteteve Palë për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore nënujore nëpërmjet të gjitha masave praktike të marra në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të parandaluar rrezikun e menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, duke përfshirë grabitjet, shteti bashkërendues mund të marrë të gjitha masat praktike, dhe/ose nxjerrë çdo autorizim të nevojshëm në pajtim me këtë Konventë dhe, nëse është e nevojshme para bisedimeve, të parandalojë çdo rrezik të menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, që rrjedh nga aktivitetet njerëzore ose çdo shkak tjetër, duke përfshirë grabitjen. Në marrjen e këtyre masave, mund të kërkohej asistencë nga Shtetet e tjera Palë.

5. Shteti bashkërendues:

a) zbaton masat e mbrojtjes për të cilat është rënë dakord nga shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, përveçse kur shtetet konsultuese që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë do t'i zbatojë këto masa;

b) nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këto masa të rëna dakord në pajtim me rregullat, përveçse kur shtetet konsultuese që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë do t'i nxjerrë ato autorizime;

c) mund të kryejë çdo kërkim paraprak të nevojshëm në trashëgiminë kulturore nënujore dhe nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këtë dhe njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm për rezultatet që nga ana tjetër ua ofron këtë informacion menjëherë Shteteve të tjera Palë.

6. Në bashkërendimin e konsultimeve, marrjen e masave, kryerjen e kërimit paraprak dhe/ose nxjerrjen e autorizimeve në pajtim me këtë nen, shteti bashkërendues vepron në emër të Shteteve Palë si një të tërë dhe jo në interes të vet. Çdo veprim i tillë nuk përbën në vetvete një bazë për të konfirmuar ndonjë të drejtë preferenciale ose juridiksionale që nuk është e parashikuar në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

7. Në pajtim me dispozitat e paragrafëve 2 dhe 4 të këtij neni, asnjë aktivitet drejtuar ndaj mjeteve lundruese ose fluturuese të shtetit nuk mund të kryhet pa pëlqimin e shtetit të flamurit dhe bashkëpunimin e shtetit bashkërendues.

Neni 11

Raportimi dhe njoftimi në zonë

1. Shtetet Palë kanë përgjegjësi për ta ruajtur trashëgiminë kulturore nënujore në zonë në pajtim me këtë Konventë dhe nenin 149 të konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit. Kështu, nëse një shtetas ose një mjet lundrimi që ka flamurin e një Shteti Palë zbulon ose synon të përfshihet në aktivitete të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në zonë, ai Shtet Palë kërkon që shtetasi i tij ose kapiteni i mjetit lundrues t'ia raportojë atij këtë zbulim ose aktivitet.

2. Shtetet Palë njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit Detar për këto zbulime dhe aktivitete që u raportohen atyre.

3. Drejtori i Përgjithshëm u bën të ditur menjëherë të gjitha Shteteve Palë çdo informacion të dhënë nga Shtetet Palë.

4. Çdo Shtet Palë mund t'i deklarojë Drejtorit të Përgjithshëm interesin e tij për t'u konsultuar si të sigurohet mbrojtja e efektshme e trashëgimisë kulturore nënujore. Kjo deklaratë bazohet në një lidhje të verifikueshme me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse, ku u kushtohet rëndësi veçanërisht të drejtave preferenciale të shteteve me origjinë kulturore, historike ose arkeologjike.

Neni 12

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore në zonë

1. Asnjë autorizim nuk jepet për aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që gjendet në zonë, përveçse në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Drejtori i Përgjithshëm fton të gjitha Shtetet Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 11, paragrafi 4, të konsultohen si të mbrojnë më mirë trashëgiminë kulturore nënujore, dhe ta caktojnë një Shtet Palë për t'i bashkërenduar këto konsultime si "Shteti bashkërendues". Drejtori i Përgjithshëm fton gjithashtu Autoritetin Ndërkombëtar të Shtratit Detar për të marrë pjesë në këto konsultime.

3. Të gjitha Shtetet Palë mund të marrin të gjitha masat praktike në pajtim me këtë Konventë, nëse është e nevojshme para konsultimeve, për të parandaluar çdo rrezik të menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, qoftë nga aktiviteti i njeriut apo nga një shkak tjetër duke përfshirë grabitjet.

4. Shteti bashkërendues:

a) zbaton masat e mbrojtjes që janë rënë dakord nga shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, përveçse kur shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që këto masa do t'i zbatojë një Shtet tjetër Palë; dhe

b) nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këto masa të rëna dakord në pajtim me këtë Konventë, përveçse kur shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë i nxjerr ato autorizime.

5. Shteti bashkërendues mund të kryejë çdo kërkim paraprak të nevojshëm në trashëgiminë kulturore nënujore dhe nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këtë dhe njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm për rezultatet që nga ana tjetër ua bën të ditur këtë informacion Shteteve të tjera Palë.

6. Për bashkërendimin e konsultimeve, marrjen e masave, zhvillimin e kërkimit paraprak, dhe/ose nxjerrjen e autorizimeve në pajtim me këtë nen, shteti bashkërendues vepron në të mirë të njerëzimit si një i tërë, në emër të Shteteve Palë. Vëmendje e rëndësishme u kushtohet të drejtave preferenciale të shteteve me origjinë kulturore, historike ose arkeologjike në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse.

7. Asnjë Shtet Palë nuk ndërmerr apo autorizon aktivitete drejtuar ndaj mjeteve të lundrimit dhe fluturimit në zonë pa pëlqimin e shtetit të flamurit.

Neni 13

Imuniteti sovran

Luftanijet dhe anijet e tjera qeveritare ose avionët luftarakë me imunitet sovran, të operuara për qëllime jotregtare, që zhvillojnë operacione në mënyrën e tyre normale dhe nuk përfshihen në aktivitete që drejtohen ndaj trashëgimisë kulturore nënujore nuk janë të detyruara të raportojnë zbulimet e trashëgimisë kulturore nënujore sipas neneve 9, 10, 11 dhe 12 të kësaj Konvente. Megjithatë, Shtetet Palë sigurojnë,

nëpërmjet miratimit të masave të përshtatshme që nuk cenojnë operacionet ose aftësinë operative të luftanijeve të tyre ose anijeve të tjera qeveritare ose avionëve luftarakë me imunitet sovran që operohen jo për qëllime tregtare, që ata të respektojnë, në masën që është e arsyeshme dhe praktike, nenet 9, 10, 11 dhe 12 të kësaj Konvente.

Neni 14

Kontrolli i hyrjes në territor, trajtimi dhe zotërimi

Shtetet Palë marrin të gjitha masat për të parandaluar hyrjen në territorin e tyre, trajtimin ose zotërimin e trashëgimisë kulturore nënujore të eksportuar në mënyrë të paligjshme dhe/ose të rikuperuar, nëse rikuperimi ka qenë në kundërshtim me këtë Konventë.

Neni 15

Mospërdorimi i zonave nën juridiksionin e Shteteve Palë

Shtetet Palë marrin masa për të ndaluar përdorimin e territorit të tyre, duke përfshirë portet detare, si dhe ishujt artificialë, instalimet dhe strukturat nën juridiksionin dhe kontrollin e tyre ekskluziv në mbështetje të çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që nuk është në pajtim me këtë Konventë.

Neni 16

Masat në lidhje me shtetasit dhe mjetet e lundrimit

Shtetet Palë marrin të gjitha masat praktike për të siguruar që shtetasit e tyre dhe mjetet e lundrimit me flamurin e tyre të mos përfshihen në asnjë aktivitet të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë Konventë.

Neni 17

Sanksionet

1. Secili Shtet Palë vendos sanksione për shkeljen e masave që ai ka marrë për zbatimin e kësaj Konvente.
2. Sanksionet e zbatueshme në lidhje me shkeljet do të kenë ashpërsi të përshtatshme për të qenë të efektshme për të siguruar përputhjen me këtë Konventë dhe për të penguar shkeljet kurdoherë që të ndodhin dhe për t'u hequr shkelësve përfitimet që rrjedhin nga aktivitetet e tyre të paligjshme.
3. Shtetet Palë bashkëpunojnë për të siguruar ekzekutimin e sanksioneve të caktuara sipas këtij neni.

Neni 18

Sekuestrimi dhe disponimi i trashëgimisë kulturore nënujore

1. Secili Shtet Palë merr të gjitha masat që sigurojnë sekuestrimin e trashëgimisë kulturore nënujore në territorin e tij që është përfshirë në një mënyrë jo në pajtim me këtë Konventë.
2. Secili Shtet Palë regjistron, mbron dhe merr të gjitha masat e arsyeshme për të stabilizuar trashëgiminë kulturore nënujore të sekuestruar sipas kësaj Konvente.
3. Secili Shtet Palë njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe çdo shtet tjetër me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse për çdo sekuestrim të trashëgimisë kulturore nënujore që ka bërë sipas kësaj Konvente.
4. Një Shtet Palë që ka sekuestruar trashëgimi kulturore nënujore siguron që disponimi i saj të jetë në të mirë të publikut, duke marrë parasysh nevojën për konservim dhe kërkim; nevojën për ribashkimin e koleksionit të shpërndarë; nevojën për aksesin e publikut, ekspozimin dhe edukimin; dhe interesat e çdo shteti me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike dhe arkeologjike, në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse.

Neni 19

Bashkëpunimi dhe njoftimi i informacionit

1. Shtetet Palë bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin në mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore nënujore sipas kësaj Konvente, duke përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin në

hetimin, nxjerrjen, dokumentimin, konservimin, studimin dhe prezantimin e kësaj trashëgimie.

2. Në masën që përputhet me qëllimet e kësaj Konvente, secili Shtet Palë merr përsipër ta bëjë të ditur informacionin Shteteve të tjera Palë në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore, duke përfshirë zbulimin e trashëgimisë, vendndodhjen e trashëgimisë, trashëgiminë e nxjerrë ose përftuar në kundërshtim me këtë Konventë ose përndryshe duke shkelur të drejtën ndërkombëtare, metodologjinë dhe teknologjinë shkencore përkatëse dhe zhvillimet ligjore në lidhje me këtë trashëgimi.

3. Informacioni i bërë i ditur ndërmjet Shteteve Palë ose ndërmjet UNESCO-s dhe Shteteve Palë në lidhje me zbulimin ose vendndodhjen e trashëgimisë kulturore nënujore, në masën që është në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, mbahet konfidencial dhe i rezervuar për autoritetet kompetente të Shteteve Palë nëse deklarimi i këtij informacioni do të rrezikonte ose përbënte rrezik për ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore nënujore.

4. Secili Shtet Palë merr të gjitha masat praktike për të shpërndarë informacion, duke përfshirë, sipas rastit, nëpërmjet bazave ndërkombëtare të përshtatshme të të dhënave në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore të nxjerrë ose përftuar në kundërshtim me këtë Konventë ose ndryshe në shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 20

Ndërgjegjësimi publik

Secili Shtet Palë merr të gjitha masat praktike për të rritur ndërgjegjësimin publik në lidhje me vlerën dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore nënujore dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj sipas kësaj Konvente.

Neni 21

Trajnimi në arkeologjinë nënujore

Shtetet Palë bashkëpunojnë në sigurimin e trajnimit në arkeologjinë nënujore, në teknikat e konservimit të trashëgimisë kulturore nënujore dhe sipas termave të rëna dakord, në transferimin e teknologjisë në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore.

Neni 22

Autoritetet kompetente

1. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i përshtatshëm i kësaj Konvente, Shtetet Palë themelojnë autoritete kompetente ose përforcojnë ekzistuesit, sipas rastit, me qëllim ngritjen, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një inventari të trashëgimisë kulturore nënujore, ruajtjen, konservimin, prezantimin dhe menaxhimin e efektshëm të trashëgimisë kulturore nënujore, si dhe kërkimin dhe edukimin.

2. Shtetet Palë i komunikojnë Drejtorit të Përgjithshëm emrat dhe adresat e autoriteteve të tyre kompetente në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore.

Neni 23

Mbledhjet e Shteteve Palë

1. Drejtori i Përgjithshëm thërret një mbledhje të Shteteve Palë brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente dhe pas kësaj të paktën një herë në dy vjet. Me kërkesë të një shumice të Shteteve Palë, Drejtori i Përgjithshëm thërret një mbledhje të jashtëzakonshme të Shteteve Palë.

2. Mbledhja e Shteteve Palë vendos në lidhje me funksionet dhe përgjegjësitë e saj.

3. Mbledhja e Shteteve Palë miraton rregullat e saj të procedurës.

4. Mbledhja e Shteteve Palë ngre një organ këshillues shkencor dhe teknik, të përbërë nga ekspertë të emëruar nga Shtetet Palë, duke i kushtuar rëndësi të veçantë parimit të shpërndarjes së drejtë gjeografike dhe preferencës së balancës gjinore.

5. Organi këshillimor shkencor dhe teknik ndihmon rregullisht mbledhjen e Shteteve Palë në çështjet e natyrës shkencore dhe teknike në lidhje me zbatimin e rregullave.

Neni 24

Sekretariati i Konventës

1. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionet e sekretariatit të kësaj Konvente.

2. Detyrat e sekretariatit përfshijnë:

- a) organizimin e mbledhjeve të Shteteve Palë sipas parashikimit në nenin 23, paragrafi 1; dhe
- b) ndihmesën e Shteteve Palë në zbatimin e vendimeve të mbledhjeve të Shteteve Palë.

Neni 25

Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës u nënshtrohet negociatave në mirëbesim ose mjeteve të tjera paqësore për zgjidhjen sipas zgjedhjes së tyre.

2. Nëse këto negociata nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati të arsyeshëm kohor, ajo mund t'i paraqitet UNESCO-s për ndërmjetësim, me marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të interesuara.

3. Nëse ndërmjetësimi nuk fillon ose nëse nuk ka zgjidhje me ndërmjetësim, dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që gjenden në pjesën XV të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit zbatohet *mutatis mutandis* për çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Palë në këtë Konventë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, pavarësisht nëse ata janë Palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

4. Çdo procedurë e zgjedhur nga një Shtet Palë në këtë Konventë dhe në konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit në pajtim me nenin 287 të kësaj të fundit zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij neni, përveçse kur ai Shtet Palë, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo moment pas kësaj, zgjedh një procedurë tjetër në pajtim me nenin 287 për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kjo Konventë.

5. Një Shtet Palë në këtë Konventë që nuk është palë në konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo kohë pas kësaj është i lirë të zgjedhë, me anë të një deklaratë me shkrim, një ose më shumë nga mjetet e parashikuara në nenin 287, paragrafi 1 i konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas këtij neni. Neni 287 zbatohet për këtë deklaratë, si dhe për çdo mosmarrëveshje tek e cila ky shtet është palë, që nuk mbulohet nga një deklaratë në fuqi. Për qëllimin e pajtimit dhe arbitrazhit, në pajtim me anekset V dhe VII të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, ky shtet ka të drejtën të emërojë ndërmjetës ose arbitra për t'u përfshirë në listat e përmendura në aneksin V, neni 2 dhe aneksin VII, neni 2 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kjo Konventë.

Neni 26

Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare të UNESCO-s.

2. Kjo Konventë është e hapur për aderim:

a) nga shtetet që nuk janë anëtare të UNESCO-s, por janë anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të një agjencie të specializuar brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, si dhe nga Shtetet Palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe çdo shtet tjetër i ftuar për të aderuar në këtë Konventë nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s;

b) nga territoret që gëzojnë vetëqeverisje të brendshme, e njohur si e tillë nga Kombet e Bashkuara, por që nuk kanë arritur pavarësinë e plotë në pajtim me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 1514 (XV) dhe që ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të hyrë në traktate në lidhje me këto çështje.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzetë të përmendur në nenin 26, por vetëm në lidhje me njëzet shtetet ose territoret që kanë depozituar instrumentet e tyre. Ajo hyn në fuqi për çdo shtet ose territor tjetër tre muaj pas datës në të cilën ai shtet ose territor ka depozituar instrumentin e tij.

Neni 28

Deklarimi për ujërat e brendshme

Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të kësaj Konvente ose në çdo moment pas këtij, çdo shtet ose territor mund të deklarojë që rregullat zbatohen për ujërat e brendshme jo të një natyre detare.

Neni 29

Kufizimet e objektit gjeografik

Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet ose territor mund ta bëjë një deklaratë të depozitari që kjo Konventë nuk do të jetë e zbatueshme në pjesë të caktuara të territorit, ujërave të brendshme, ujërave arkipelagjike ose detin e tij territorial dhe identifikon në të shkaqet për një deklaratë të tillë. Ky shtet, në masën që është praktike dhe menjëherë sapo të jetë e mundur, nxit kushtet sipas të cilave zbatohet kjo Konventë në zonat e përcaktuara në deklaratën e tij dhe për këtë qëllim tërheq gjithashtu deklaratën e tij plotësisht ose pjesërisht menjëherë sapo ajo të jetë arritur.

Neni 30

Rezervat

Me përjashtim të nenit 29, kësaj Konvente nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 31

Ndryshimet

1. Një Shtet Palë, me komunikim me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të propozojë ndryshime në këtë Konventë. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë komunikim te të gjitha Shtetet Palë. Nëse, brenda gjashtë muajve nga data e qarkullimit të komunikimit, jo më pak se gjysma e Shteteve Palë përgjigjen pozitivisht ndaj kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në mbledhjen e radhës të Shteteve Palë për diskutim dhe miratim të mundshëm.

2. Ndryshimet miratohen nga një shumicë prej dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë.

3. Pas miratimit, ndryshimet e Konventës i nënshtrohen ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga Shtetet Palë.

4. Ndryshimet hyjnë në fuqi, por vetëm për Shtetet Palë që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në to, tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni me dy të tretat e Shteteve Palë. Pas kësaj, për çdo shtet ose territor që e ratifikon, pranon, miraton ose aderon në të, ndryshimi hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ajo palë të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

5. Një shtet ose territor që bëhet palë në këtë Konventë ose pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, nëse mungon shprehja e një qëllimi të ndryshëm nga ai shtet ose territor, konsiderohet:

a) Palë në Konventën e ndryshuar; dhe

b) Palë në Konventën e pandryshuar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk i nënshtrohet ndryshimit.

Neni 32

Denoncimi

1. Një Shtet Palë e denoncon këtë Konventë me njoftim me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes së njoftimit, përveçse kur njoftimi përcakton një datë të mëvonshme.

3. Denoncimi nuk cenon në asnjë mënyrë detyrën e çdo Shteti Palë për të përmbushur çdo detyrim të parashikuar nga kjo Konventë të cilit do t'i nënshtrohej në pajtim me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga kjo Konventë.

Neni 33
Rregullat

Rregullat bashkëngjitur kësaj Konvente përbëjnë një pjesë integrale të saj dhe, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë në këtë Konventë përfshin një referencë të rregullat.

Neni 34
Regjistrimi të Kombet e Bashkuara

Në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet te sekretariati i Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 35
Tekstet autentike

Kjo Konventë është hartuar në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, dhe të gjashtë tekstet janë njëloj autentike.

ANEKS

RREGULLAT NË LIDHJE ME AKTIVITETET DREJTUAR NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE

I. Parime të përgjithshme

Rregulli 1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore nëpërmjet ruajtjes *in situ* konsiderohet si opsion i parë. Përkatësisht, aktivitetet drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore autorizohen në një mënyrë në pajtim me mbrojtjen e asaj trashëgimie dhe në pajtim me këtë kërkesë mund të jepet autorizimi me qëllim dhënien e një kontributi të rëndësishëm për mbrojtjen ose njohurinë, ose rritjen e trashëgimisë kulturore nënujore.

Rregulli 2. Shfrytëzimi tregtar i trashëgimisë kulturore nënujore për tregtim ose spekulim apo shpërndarja e saj e pakthyeshme është katërcipërisht në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin e rregullt të trashëgimisë kulturore nënujore. Trashëgimia kulturore nënujore nuk tregtohet, shitet, blihet ose këmbëhet si mall në treg.

Rregulli nuk mund të interpretohet sikur pengon:

a) dhënien e shërbimeve profesionale arkeologjike ose shërbimeve të nevojshme për t'u dhënë, natyra dhe qëllimi i të cilave është në përputhje të plotë me Konventën dhe i nënshtrohen autorizimit të autoriteteve kompetente;

b) depozitimin e trashëgimisë kulturore nënujore, të përfshirë në kontekstin e një projekti kërkimor në pajtim me këtë Konventë, me kusht që një depozitim i tillë të mos cenojë interesin shkencor ose kulturor, ose integritetin e materialit të përfshirë ose të rezultojë në shpërndarje të pakthyeshme; të jetë në pajtim me dispozitat e rregullave 33 dhe 34; dhe t'i nënshtrohet autorizimit të autoriteteve kompetente.

Rregulli 3. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore nuk ndikojnë negativisht në trashëgiminë kulturore nënujore më shumë nga sa është e nevojshme për objektivat e projektit.

Rregulli 4. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore duhet të përdorin teknika joshkatërruese dhe metodat e vrojtimit dhe jo të përfshijë të objekteve. Nëse është i nevojshëm gjurmimi ose përfshirja për qëllimin e studimeve shkencore ose për mbrojtjen përfundimtare të trashëgimisë kulturore nënujore, metodat dhe teknikat e përdorura duhet të jenë sa më pak shkatërruese që të jetë e mundur dhe të kontribuojnë në ruajtjen e pjesëve të mbetura.

Rregulli 5. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore shmangin ndërhyrjet e panevojshme të mbetjet njerëzore ose vendet e nderuara.

Rregulli 6. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore rregullohen rigorozisht për të siguruar regjistrimin e përshtatshëm të informacionit kulturor, historik dhe arkeologjik.

Rregulli 7. Hyrja publike në trashëgiminë kulturore nënujore *in situ* nxitet, me përjashtim të rasteve kur kjo hyrje është në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin.

Rregulli 8. Bashkëpunimi ndërkombëtar në zhvillimin e aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore inkurajohet me qëllim nxitjen e shkëmbimit ose përdorimit të efektshëm të arkeologëve dhe profesionistëve të tjerë përkatës.

II. Disenjoja e projektit

Rregulli 9. Para çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, përpilohet një disenjo projekti për aktivitetin dhe u paraqitet autoriteteve kompetente për autorizimin dhe studimin e përshtatshëm.

Rregulli 10. Disenjoja e projektit përfshin:

- a) një vlerësim të studimeve të mëparshme ose paraprake;
- b) deklarinimin dhe objektivat e projektit;
- c) metodologjinë që përdoret dhe teknikat që zbatohen;
- d) financimin e parashikuar;
- e) një afat të pritshëm kohor për përfundimin e projektit;
- f) përbërjen e ekipit dhe kualifikimet, përgjegjësitë dhe eksperiencën e secilit anëtar të ekipit;
- g) planet për analizat pas punës në terren dhe aktivitetet e tjera;
- h) një program konservimi për veglat parahistorike dhe vendin në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente;
- i) një politikë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit;
- j) një program dokumentimi;
- k) një politikë sigurie;
- l) një politikë për ambientin;
- m) masat për bashkëpunimin me muzetë dhe institucionet e tjera, në institucione të veçanta shkencore;
- n) përgatitjen e raportit;
- o) depozitimin e arkivave, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore të hequr; dhe
- p) një program publikimi.

Rregulli 11. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore zhvillohen në pajtim me disenjon e projektit të miratuar nga autoritetet kompetente.

Rregulli 12. Nëse bëhen zbulime të papritura ose ndryshojnë rrethanat, disenjoja e projektit rishikohet dhe ndryshohet me miratimin e autoriteteve kompetente.

Rregulli 13. Në rastet e urgjencës ose zbulimeve të rastësishme, aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, duke përfshirë masat e konservimit ose aktivitetet për një periudhë kohëzgjatjeje të shkurtër, veçanërisht stabilizimi i vendeve, mund të autorizohen në mungesë të një disenjoje projekti me qëllim që të mbrohet trashëgimia kulturore nënujore.

III. Puna paraprake

Rregulli 14. Puna paraprake e përmendur në rregullin 10 (a) përfshin një vlerësim që mat rëndësinë dhe prekmërinë e trashëgimisë kulturore nënujore dhe ambientit natyror rrethues nga dëmtimi nëpërmjet projektit të propozuar dhe mundësinë për të marrë të dhëna që do të përmbushnin objektivat e projektit.

Rregulli 15. Vlerësimi përfshin gjithashtu studime paraprake mbi provat ekzistuese historike dhe arkeologjike, karakteristikat arkeologjike dhe ambientaliste të vendit dhe pasojat e çdo ndërhyrjeje të mundshme për stabilitetin afatgjatë të trashëgimisë kulturore nënujore të ndikuar nga aktivitetet.

IV. Objektivi, metodologjia dhe teknikat

Rregulli 16. Metodologjia përputhet me objektivat e projektit dhe teknikat e zbatuara do të jenë sa më pak dëmtuese që të jetë e mundur.

V. Financimi

Rregulli 17. Përveçse në rastet e emergjencës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, sigurohet një bazë e përshtatshme financimi për çdo aktivitet, e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha fazat e disenjos së projektit, duke përfshirë konservimin, dokumentimin dhe ndreqjen e veglave të punës të gjetura, përgatitjen dhe shpërndarjen e raportit.

Rregulli 18. Disenjoja e projektit demonstroi një aftësi, si sigurimi i një obligacioni, për ta financuar projektin deri në fund.

Rregulli 19. Disenjoja e projektit përfshin një plan emergjence që do të sigurojë konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore dhe dokumentacionin mbështetës në rastin e çdo ndërprerjeje të financimit të planifikuar.

VI. Kohëzgjatja e projektit – grafiku kohor

Rregulli 20. Një grafik kohor i përshtatshëm zhvillohet për të siguruar para çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore përfundimin e të gjitha fazave të disenjos së projektit, duke

përfshirë konservimin, dokumentimin dhe ndreqjen e trashëgimisë kulturore nënujore të përfutur, si dhe përgatitjen dhe shpërndarjen e raportit.

Rregulli 21. Disenjoja e projektit përfshin një plan emergjence që do të sigurojë konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore dhe dokumentacionin mbështetës në rastin e ndërprerjes ose mospërfundimit të projektit.

VII. Aftësitë dhe kualifikimet

Rregulli 22. Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore ndërmerren vetëm nën drejtimin dhe kontrollin, si dhe në praninë e përshtatshme të arkeologut të kualifikuar nënujor me aftësi shkencore të përshtatshme për projektin.

Rregulli 23. Të gjithë personat e ekipit të projektit janë të kualifikuar dhe kanë aftësi të demonstruara, të përshtatshme për rolet e tyre në projekt.

VIII. Konservimi dhe menaxhimi i vendit

Rregulli 24. Programi i konservimit parashikon trajtimin e mbetjeve arkeologjike gjatë aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, përkohësisht dhe në një afat të gjatë. Konservimi kryhet në pajtim me standardet e tashme profesionale.

Rregulli 25. Programi i menaxhimit të vendit parashikon mbrojtjen dhe menaxhimin *in situ* të trashëgimisë kulturore nënujore, gjatë dhe me përfundimin e punës në terren. Programi përfshin informacionin publik, parashikim të arsyeshëm për stabilizimin e vendit, monitorimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet.

IX. Dokumentimi

Rregulli 26. Programi i dokumentimit parashikon dokumentim të hollësishëm duke përfshirë një raport progresi të aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, në pajtim me standardet e tashme profesionale të dokumentimit arkeologjik.

Rregulli 27. Dokumentimi përfshin, minimalisht, një regjistrim të plotë të vendit, duke përfshirë origjinën e trashëgimisë kulturore nënujore të lëvizur ose të hequr gjatë aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, shënime të terrenit, plane, skica, seksione dhe fotografi apo regjistrim në mjete të tjera.

X. Siguria

Rregulli 28. Përpilohet një politikë sigurie që është e përshtatshme të garantojë sigurinë dhe shëndetin e ekipit të projektit dhe palëve të treta dhe që është në pajtim me çdo kërkesë të zbatueshme statutore dhe profesionale.

XI. Ambienti

Rregulli 29. Përpilohet një politikë ambienti që është e përshtatshme për të garantuar që jeta e shtratit të detit dhe detare të mos cenohen në mënyrë të papërshtatshme.

XII. Raportimi

Rregulli 30. Raporte të përkohshme dhe përfundimtare jepen në pajtim me grafikun kohor të parashikuar në disenjon e projektit dhe të depozituar në regjistrat përkatës publikë.

Rregulli 31. Raportet përfshijnë:

- a) një përshkrim të objektivave;
- b) një përshkrim të metodave dhe teknikave të zbatuara;
- c) një përshkrim të rezultateve të arritura;
- d) dokumentacion bazë grafik dhe fotografik për të gjitha fazat e aktivitetit;
- e) rekomandime në lidhje me konservimin dhe rregullimin e vendit dhe të çdo trashëgimie kulturore nënujore të hequr; dhe
- f) rekomandimet për aktivitete të ardhshme.

XIII. Rregullimi i arkivave të projektit

Rregulli 32. Për masat për rregullimin e arkivave të projektit bihet dakord para fillimit të çdo aktiviteti dhe këto përcaktohen në disenjon e projektit.

Rregulli 33. Arkivat e projektit, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore të hequr dhe një kopje të gjithë dokumentacionit shoqërues, në masën që është e mundur, mbahen së bashku dhe të paprekur si një koleksion në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për akses profesional dhe publik, si dhe për rregullimin e arkivave. Kjo duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se dhjetë vjet nga përfundimi i projektit, në masën që mund të jetë në përputhje me konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore.

Rregulli 34. Arkivat e projektit menaxhohen në pajtim me standardet profesionale ndërkombëtare dhe në bazë të autorizimit nga autoritetet kompetente.

XIV. Shpërndarja

Rregulli 35. Projektet parashikojnë edukim publik dhe bërjen publike të rezultateve të projektit, sipas rastit.

Rregulli 36. Një përmbledhje përfundimtare e një projekti:

a) bëhet publike sa më shpejt të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi kompleksitetit të projektit dhe natyrës konfidenciale dhe sensitive të informacionit; dhe

b) depozitohet te regjistrat përkatës publikë.

Bërë në Paris, më 6 nëntor 2001 në dy kopje autentike, të nënshkruara nga kryetari i sesionit të tridhjetenjtë të Konferencës së Përgjithshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, që do të depozitohen në arkivat e Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara dhe kopje të vërtetuara të të cilave do t'u jepen të gjitha shteteve dhe territoreve të përmendura në nenin 26, si dhe Kombeve të Bashkuara.

Teksti zyrtar: anglisht, frëngjisht

Anglisht

Frëngjisht

Spanjisht

Rusisht

Gjuha kineze

Arabisht

Data e miratimit 2001

Deklarata dhe rezerva

LIGJ

Nr.10 028, datë 11.12.2008

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN NDËRKOMBËTARE PËR ULLIRIN DHE VAJIN E ULLIRIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen ndërkombëtare për ullirin dhe vajin e ullirit” të vitit 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2009.

**Shpallur me dekretin nr.5979, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TREGTINË DHE ZHVILLIMIN
MARRËVESHJA NDËRKOMBËTARE PËR
VAJIN E ULLIRIT DHE ULLINJTË E TAVOLINËS, 2005
KOMBET E BASHKUARA

HYRJE

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Negocimin e Marrëveshjes Pasardhëse të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës, 1986, e amenduar dhe e zgjeruar, 1993, u mbajt në Palais des Nations, Gjenevë, nga data 25 deri 29 prill 2005. Palët e Marrëveshjes ekzistuese dhe të gjitha shtetet anëtare të UNCTAD, si dhe disa agjenci të specializuara të interesuara të Kombeve të Bashkuara u ftuan për të marrë pjesë në Konferencë.

Konferenca kishte para saj drafttekstin e marrëveshjes së re ndërkombëtare për vajin e ullirit dhe ullinjtë e tavolinës që ishte rezultati i diskutimeve të zhvilluara nga një grup pune i krijuar posaçërisht nga Këshilli Ndërkombëtar i Vajit të Ullirit që miratoi vendimin e tij nr.DEC-7/90-IV/2004 në sesionin e tij të 90-të të mbajtur në tetor 2004.

Konferenca u hap nga z.Carlos Fortin, zyrtari përgjegjës i UNCTAD më 25 prill 2005 dhe zgjodhi z.François Roux (Belgjikë) si kryetar të saj dhe z.Samir Labidi (Tunizi) si zëvendëskryetar. Z.Habib Essid, drejtori ekzekutiv i Këshillit Ndërkombëtar të Vajit të Ullirit dhe z.Alexander Tilgenkamp, kryetar i Këshillit Ndërkombëtar të Vajit të Ullirit, vepruan si konsulentë të konferencës. Znj.Lisanne Losier ishte sekretare e konferencës dhe z.Carlos Moreno ishte në cilësinë e këshilltarit ligjor të konferencës.

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për negocimin e marrëveshjes pasardhëse të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës u ndoq nga përfaqësues të 19 shteteve dhe katër organizata ndërqeveritare.

Gjatë punimeve të saj, konferenca mbajti dy sesione plenare. Në sesionin e saj të parë plenar më 25 prill 2005, konferenca miratoi axhendën¹ e saj dhe rregullat e saj të procedurës² dhe krijoi një komitet kryesor të përgjithshëm për të shqyrtuar pikat e axhendës 7 dhe 8 në sesionin përmbyllës, ajo miratoi një rezolutë³ dhe hartoi tekstin e Marrëveshjes Ndërkombëtare të Vajit të Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës, 2005.

AXHENDA E KONFERENCËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NEGOCIMIN E NJË MARRËVESHJEJE PASARDHËSE TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE PËR VAJIN E ULLIRIT DHE ULLINJTË E TAVOLINËS, 1986, SI DHE E AMENDUAR DHE E ZGJERUAR, 1993

1. Hapja e konferencës
2. Miratimi i axhendës
3. Miratimi i rregullave të procedurës
4. Zgjedhja e nëpunësve
5. Kredencialet e përfaqësuesve
 - a) Caktimi i komitetit të kredencialeve
 - b) Raporti i komitetit të kredencialeve
6. Krijimi i komitetit kryesor dhe komiteve të tjera, nëse kërkohet.
7. Përgatitja e një marrëveshjeje pasardhëse të Marrëveshjes Ndërkombëtare të Vajit të Ullirit dhe Ullinjve të Tavolinës, 1986, si dhe e amenduar dhe e zgjeruar, 1993.
8. Konsiderata dhe miratimi i rezolutave përfundimtare
9. Çështje të tjera.

REZOLUTA E MIRATUAR NGA KONFERENCA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR
VAJIN E ULLIRIT DHE ULLINJTË E TAVOLINËS, 2005

Rezoluta përfundimtare

Konferenca e Kombeve të Bashkuara për negocimin e një marrëveshjeje pasardhëse të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës, 1986, si dhe e amenduar dhe e

¹ TD/VAJI I ULLIRIT.10/1

² TD/VAJI I ULLIRIT.10/2

³ TD/VAJI I ULLIRIT.10/5

zgjeruar, 1993;

duke u takuar në Gjenevë nga data 25 deri 29 prill 2005;

duke shprehur mirënjohjen e saj për lehtësirat dhe shërbimet e siguruara nga Sekretari i Përgjithshëm i UNCTAD-i;

duke shënuar vlerësimin e tij të kontributit të bërë nga kryetari i konferencës dhe nga zyrtarët e tij, si dhe nga sekretariati;

duke hartuar tekstet autentike të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinës, 2005, në gjuhën arabe, angleze, frënge dhe spanjolle;

1. *i kërkon* Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit të marrë masat e nevojshme për vendosjen në emër të konferencës të tekstit italisht të marrëveshjes;

2. *vendos* që tekstet e hartuara në gjuhën arabe, angleze, frënge, italiane dhe spanjolle do të jenë njëllëj autentike;

3. *kërkon* që këto tekste, të vërtetuara nga nënshkrimi i sekretariatit të konferencës t'i jenë transmetuar qeverisë së Spanjës si depozitare e marrëveshjes;

4. *i kërkon* qeverisë depozitare të marrë masa që marrëveshja të jetë e hapur në Madrid për nënshkrim gjatë periudhës së përcaktuar në nenin 39 të Marrëveshjes, dhe të jetë e regjistruar me hyrjen në fuqi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Takimi i dytë plenar
29 prill 2005

LISTA E SHTETEVE DHE ORGANIZATAVE TË PËRFAQËSUARA NË KONFERENCËN E
KOMBEVE TË BASHKUARA PËR NEGOCIMIN E NJË MARRËVESHJEJE PASARDHËSE TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE TË VAJIT TË ULLIRIT DHE ULLINJVE TË TAVOLINËS,
1986,DHE E AMENDUAR DHE E ZGJERUAR, 1993⁴

Pjesëmarrësit:

Shqipëria

Algjeria

Belgjika

Republika Çeke

Republika Domenikane

Egjipti

Franca

Gjermania

Greqia

Iraku

Irani (Republika Islamike)

Italia

Jordania

Maroku

Federata Ruse

Spanja

Tunizia

Turqia

*

* *

Organizatave ndërqeveritare

Grupi i shteteve afrikane, Karaibeve dhe Paqësorit

Komisioni European

Këshilli i Europës

Këshilli Ndërkombëtar i Vajit të Ullirit

PREAMBULA

Palët në këtë Marrëveshje,

⁴ Për listën e pjesëmarrësve shih TD/vaj ulliri.10/INF.

duke theksuar që kultivimi i ullirit rregullon ekzistencën dhe standardin e jetesës së miliona familjeve të cilat janë të varura nga masat e marra për ruajtjen dhe zgjerimin e konsumit të produkteve të ullirit dhe për zhvillimin e ekonomisë botërore për produkte të tilla;

duke pasur në konsideratë që pema e ullirit është një bimë e nevojshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tokës si rezultat i natyrës së saj shumëvjeçare dhe që është gjithashtu një instrument që zhvillon tokën dhe që nuk lidhet me bimë të tjera dhe e cila edhe nën kushte të një ekonomie bujqësore jointensive i përgjigjet në mënyrë të favorshme çfarëdo përmirësimi në kultivim;

të vetëdijshme që vaji i ullirit dhe ullinjtë e tavolinës janë produkte esenciale bazë në rajonet ku është vendosur rritja e ullirit dhe se ato janë përbërësit bazë të dietës mesdhetare dhe kohët e fundit edhe të dietave të tjera;

duke theksuar në këtë aspekt rëndësinë e veçantë të prodhimit të ullirit në ekonomitë e shumë vendeve;

të vetëdijshme që masat që duhen marrë duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rritjes së ullirit dhe të tregut për prodhimet e tij e tejkalojnë sferën kombëtare dhe veprimi ndërkombëtar është thelbësor;

duke qenë të mendimit që është thelbësore vazhdimi dhe zhvillimi i punës së ndërmarrë brenda kuadrit të marrëveshjeve të mëparshme të përfunduara që në marrëveshjen e vitit 1956 deri në marrëveshjen e vitit 1986, që është amenduar në vitin 1993 dhe që është e nevojshme të negociohet një marrëveshje e përditësuar duke marrë parasysh ndryshimet në industri;

duke marrë në konsideratë klauzolat e konsensusit të San Paolos, të sesionit të 11-të konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, kanë rënë dakord për sa më poshtë.

KAPITULLI I OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objektiva të përgjithshme

1. Në lidhje me bashkëpunimin teknik ndërkombëtar:

- të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar për një rritje dhe zhvillim të integruar të ullirit në botë;
- të nxisë bashkërendimin e prodhimit, industrializimin, ruajtjen dhe politikat e marketingut për vajrat e ullirit dhe të bërsisë së ullirit dhe ullinjtë e tavolinës;
- të nxisë kërkimin shkencor dhe zhvillimin dhe të nxisë transferimin e teknologjive dhe aktiviteteve trajnuese në sektorin e prodhimit të ullirit me qëllim ndër të tjera, të modernizimit të kultivimit të ullirit dhe të industrisë së produkteve të ullirit dhe përmirësimin e cilësisë së prodhimit;
- të krijojë bazat e bashkëpunimit ndërkombëtar në tregtinë ndërkombëtare të vajrave të ullirit, të vajrave të bërsive të ullirit dhe të ullinjve të tavolinës për të vendosur në këtë kontekst, lidhje bashkëpunimi të ngushtë me përfaqësuesit e aktorëve të ndryshëm të sektorit të produkteve të ullirit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare korresponduese;
- të vazhdojë më tej përpjekjet e bëra dhe hapat e marra për përmirësim dhe të mbajë shënime për cilësinë e produktit;

- të vazhdojë më tej përpjekjet e bëra dhe hapat e marra për të përmirësuar ndërveprimin midis kultivimit të ullirit dhe mjedisit, veçanërisht me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit;

- të shqyrtojë dhe të nxisë përdorimin e plotë të produkteve që rrjedhin nga pema e ullirit;
- të zhvillojë aktivitete për ruajtjen e burimeve gjenetike të pemës së ullirit.

2. Në lidhje me respektimin e standardizimit të tregtisë ndërkombëtare për produktet e ullirit:

- Të vazhdojë kryerjen e aktiviteteve bashkëpunuese në fushën fiziko-kimike dhe testime sensitive, me qëllim zgjerimin e njohurive për përbërjen dhe karakteristikat cilësore të produkteve të ullirit, me qëllim që të vendosë standarde ndërkombëtare që bëjnë të mundur:

- kontrollin e cilësisë së produktit;
- tregti të ndershme ndërkombëtare;
- mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;
- parandalimin e praktikave mashtruese.

- Të lehtësojë studimin dhe zbatimin e masave për harmonizimin e ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen në mënyrë të veçantë me marketingun e vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës;

- Të nxisë harmonizimin e kriterit për përcaktimin e të dhënave gjeografike të dhëna nga anëtarë, me synim mbrojtjen e tyre ndërkombëtare;

- Të hedhë bazat e bashkëpunimit ndërkombëtar për të parandaluar dhe, kur është e përshtatshme, për të luftuar çfarëdo praktike mashtruese në tregtinë ndërkombëtare në çfarëdo produkt ulliri të ngrënshtëm, duke vendosur lidhje të ngushta bashkëpunimi në këtë kontekst me përfaqësues të aktorëve të ndryshëm të sektorit të produkteve të ullirit.

3. Në lidhje me zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare dhe promovimin e produkteve të ullirit:

- Të nxisë çfarëdo aktiviteti drejtues për një zgjerim harmonik, të qëndrueshëm të ekonomisë botërore të ullirit me çdo mjet të mundshëm brenda kompetencave të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit në fushën e prodhimit, konsumit dhe tregtisë ndërkombëtare, duke pasur parasysh rrugët në të cilat ato janë të ndërlidhura;

- Të lehtësojë studimin dhe zbatimin e masave për balancimin e prodhimit dhe konsumit dhe vendosjen e procedurave për informim dhe konsultim me qëllim nxitjen e transparencës së tregut;

- Të zbatojë masat e caktuara për të zgjeruar tregtinë ndërkombëtare për produktet e ullirit dhe të miratojë çfarëdo masash që janë të përshtatshme për nxitjen e konsumit të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës;

- Të ndërmarrë aktivitete që nxisin një kuptim më të mirë të vetive ushqyese terapeutike dhe vetive të tjera të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës;

- Të ruajë dhe të rrisë rolin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit si një pikë takimi për të gjithë operatorët e sektorit dhe si një qendër botërore e dokumentacionit dhe informacionit për pemën e ullirit dhe produktet e tij.

KAPITULLI II PËRKUFIZIMET

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit” nënkupton organizatën ndërkombëtare të përmendur në nenin 3, paragrafi 1, e krijuar për qëllim të zbatimit të klauzolave të kësaj Marrëveshjeje;

2. “Këshilli i anëtarëve” nënkupton organin vendimmarrës të “Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit”;

3. “Anëtar” nënkupton Palën Kontraktuese të kësaj Marrëveshjeje;

4. “Vajra ulliri” nënkupton vajrat e marra vetëm nga fruti i pemës së ullirit, me përjashtim të vajrave të marra me solvent ose proceset e riesterifikimit dhe ndonjë përzierje me vajra të llojeve të tjera.

5. “Ullinj tavoline” nënkupton produktin e përgatitur nga frutat e pastra të varieteteve të drurit të ullirit të kultivuar, të cilët janë zgjedhur për prodhimin e tyre të ullinjve, në veçanti të përshtatshëm për t’u konservuar dhe të cilët janë trajtuar ose përpunuar në mënyrë të përshtatshme dhe janë ofruar për tregti dhe konsum përfundimtar.

6. “Produkte ulliri” nënkupton të gjitha produktet e ullirit të ngrënshtëm, në veçanti vajrat e ullirit, vajrat e bërësive të ullirit dhe ullinj të tavolinës.

7. “Nënprodukte ulliri” nënkupton në veçanti produktet që rrjedhin nga krasitja e ullinjve dhe produktet e industrisë së ullirit dhe produktet që rezultojnë nga përdorimet alternative të produkteve të sektorit.

8. “Viti i prodhimit të ullirit” nënkupton periudhën nga 1 tetori i çdo viti deri në 30 shtator të vitit në vijim.

PJESA E PARË KLAUZOLAT INSTITUCIONALE

KAPITULLI I III KËSHILLI NDËRKOMBËTAR I ULLIRIT

SEKSIONI I KRIJIMI, ORGANET, FUNKSIONET, PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 3

Krijimi, selia dhe struktura e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të veprojë nëpërmjet:
 - Kryetarit të tij;
 - Anëtarëve të tij dhe sipas rastit, komiteteve të tij dhe nënkomiteteve;
 - Sekretariatit të tij ekzekutiv,në përputhje me klauzolat e hartuara në seksionet II deri V.
2. Selia e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit do të jetë në Madrid (Spanjë), nëse këshilli i anëtarëve nuk vendos ndryshe.

Neni 4

Përfaqësimi i anëtarëve në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit

1. Çdo anëtar do të caktojë përfaqësuesin e tij në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit.
2. Çdo referencë në këtë Marrëveshje ndaj një "Qeverie" ose "Qeverive" do të interpretohet sikur përfshin Komunitetin Europian dhe çfarëdo organizatë ndërqeveritare që ka përgjegjësi në lidhje me negocimin, lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, në veçanti me marrëveshjet e produkteve. Për rrjedhojë, çfarëdo referencë në këtë marrëveshje për nënshkrim, ratifikim, pranim ose miratim për njoftimin e klauzolave ose aderim, në rastin e Komunitetit Europian ose të këtyre organizatave ndërqeveritare, do të interpretohet sikur përfshin një referencë për nënshkrim, ratifikim, pranim ose miratim, për njoftim të zbatimit të klauzolave ose për aderim nga Komuniteti Europian ose organizata të tilla ndërqeveritare.

Neni 5

Privilegjet dhe imunitetet

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ketë personalitet juridik ndërkombëtar. Ai do të ketë në mënyrë të veçantë kapacitetin për të kontraktuar, blerë dhe shitur prona të tundshme dhe të patundshme dhe për të filluar procedime ligjore. Ai nuk do të ketë kompetencë për huamarrje.
2. Në territorin e secilit anëtar dhe në shkallën që e lejon legjislacioni i anëtarit, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ketë kapacitetin ligjor të nevojshëm për përmbushjen e funksioneve që i jep kjo Marrëveshje.
3. Për qëllimet e funksionimit të rregullt të saj, statusi, privilegjet dhe imunitetet e Këshillit Ndërkombëtar të Vajit, Drejtori i tij Ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe personeli tjetër i sekretariatit të tij ekzekutiv, ekspertët dhe delegacionet e anëtarëve në territorin e Spanjës do të rregullohen nga një marrëveshje e selisë.
4. Qeveria e shtetit në të cilin ndodhet selia e Këshillit Ndërkombëtar të Vajit, në shkallën që e lejon legjislacioni i këtij shteti, do të përjashtojë nga taksimi shpërblimin e paguar nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit për nëpunësit e tij dhe asetet, të ardhurat dhe pronën tjetër të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.
5. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të lidhë me një ose më shumë anëtarë marrëveshje në lidhje me privilegje dhe imunitete të tilla që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e rregullt të kësaj Marrëveshjeje.

SEKSIONI II KËSHILLI I ANËTARËVE

Neni 6

Përbërja dhe funksionet

1. Këshilli i anëtarëve do të përbëhet nga një delegat për anëtar. Krahas kësaj, çdo anëtar mund të caktojë një ose më shumë zëvendës dhe një ose më shumë këshilltarë të delegacionit të tij.
2. Këshilli i anëtarëve do të jetë organi vendimmarrës kryesor i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Ai do të ushtrojë të tilla kompetenca dhe do të realizojë ose rregullojë përmbushjen e të gjitha funksioneve që janë të nevojshme për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i anëtarëve do të marrë çdo vendim, do të miratojë çdo rekomandim ose do të bëjë çdo sugjerim të parashikuar ose siguruar në këtë

Marrëveshje, nëse kompetencat ose funksionet i janë dhënë shprehimisht Sekretariatit Ekzekutiv ose Drejtorit Ekzekutiv.

Çdo vendim, rekomandim ose sugjerim i miratuar në përputhje me Marrëveshjen Ndërkombëtare që paraprijnë këtë Marrëveshje⁵ dhe të cilat janë në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojë të aplikohet nëse nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose nëse nuk shfuqizohet nga këshilli i anëtarëve.

3. Këshilli i anëtarëve, në përputhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje, do të miratojë:

a) rregullat e procedurës;

b) rregulloret e personelit që kanë të bëjnë me ato që zbatohen për zyrtarët e organizatave të ngjashme ndërqeveritare;

c) një organinogramë.

4. Këshilli i anëtarëve do të ndërmarrë ose kujdeset të ndërmarrë studime ose punë tjetër, duke përfshirë mbledhjen e informacionit të hollësishëm mbi lloje të ndryshme të ndihmës për aktivitete në lidhje me rritjen e ullirit dhe produktet e ullirit, në mënyrë që t'i mundësojnë të formulojë çdo rekomandim dhe sugjerim që mund ta konsiderojë të përshtatshëm për arritjen e objektivave të përgjithshme të parashtruara në nenin 1. Çdo studim dhe punë e tillë do të mbulojë në veçanti sa më shumë vende ose grupe vendesh që të jetë e mundur dhe do të marrë në konsideratë kushtet e përgjithshme sociale dhe ekonomike të vendeve të interesuara.

Anëtarët do të informojnë këshillin e anëtarëve në përputhje me një procedurë të përcaktuar nga këshilli i lartpërmendur, mbi konkluzionet që ata arrijnë pas shqyrtimit të rekomandimeve dhe sugjerimeve që lindin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

5. Këshilli i anëtarëve do të publikojë një raport vjetor mbi aktivitetet e tij dhe mbi operimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Këshilli i anëtarëve do t'i hartojë, përgatisë dhe publikojë në gjuhët zyrtare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit këto raporte, studime dhe dokumente të tjera që i konsideron të dobishme dhe të nevojshme dhe do të mbajë të përditësuara ato të dhëna që kërkon për përmbushjen e funksioneve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Sesionet e këshillit të anëtarëve

1. Këshilli i anëtarëve do të takohet në selinë e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, nëse nuk vendos ndryshe. Nëse me ftesën e ndonjë anëtari, këshilli i anëtarëve vendos të mbledhet diku tjetër, ky anëtar do të përballojë shpenzimet ekstra që përfshin buxhetin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit mbi ato për mbajtjen e një sesioni në seli.

2. Këshilli i anëtarëve do të mbajë një sesion të rregullt të paktën një herë në vit në vjeshtë.

Çdo anëtar mund të autorizojë delegatin e një anëtari tjetër të përfaqësojë interesat e tij dhe të ushtrojë të drejtën e tij për të marrë pjesë në vendimet e këshillit të anëtarëve në një ose më shumë sesione të tij. Përveç kësaj, do të paraqitet dëshmia e një autorizimi të tillë, e pranueshme për këshillin e anëtarëve.

Delegati i një anëtari mund të mos përfaqësojë interesat ose të ushtrojë të drejtën për të marrë pjesë në vendimet e këshillit të anëtarëve të më shumë se një anëtari tjetër.

3. Këshilli i anëtarëve mund të mbledhet në çdo kohë, sipas gjykimit të kryetarit të tyre.

Kryetari mundet gjithashtu të mbledhë këshillin e anëtarëve, në qoftë se kjo kërkohet nga anëtarë të ndryshëm ose nga një anëtar i mbështetur së paku nga dy anëtarë të tjerë.

4. Shpenzimet e delegacioneve në këshillin e anëtarëve do të përballohen nga vetë anëtarët.

5. Njoftimi për çdo sesion të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni do të jepet të paktën 60 ditë nga takimi i parë për çdo sesion të tillë. Njoftimi i sesioneve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni do të jepet të paktën 21 ditë para datës së takimit të parë të çdo sesioni të tillë.

6. Kuorumi i kërkuar për çdo sesion të këshillit të anëtarëve do të jetë prania e delegatëve të shumicës së anëtarëve që zënë të paktën 90 për qind të totalit të aksioneve të pjesëmarrjes e përpjesëtuara për anëtarët.

Nëse ky kuorum nuk ekziston, sesioni do të shtyhet për 24 orë dhe kuorumi i kërkuar do të jetë prania e delegatëve të anëtarëve që zënë të paktën 85 për qind të aksioneve të pjesëmarrjes totale e përpjesëtuara për anëtarët.

⁵ Marrëveshja Ndërkombëtare mbi Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinave, 1986, amenduar dhe zgjeruar, 1993, dhe zgjatuar së fundi, 2004.

7. Anëtarët vijues, me pëlqimin paraprak të këshillit të anëtarëve, mund të marrin pjesë si vëzhgues në të gjithë ose në pjesë të çdo sesiioni të këshillit të anëtarëve:

a) Organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e përmendura në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje;
b) Qeveria e ndonjë anëtarë ose shteti vëzhgues të Kombeve të Bashkuara ose një organizatë të përmendur në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje, e cila parashikon të bëhet Palë e kësaj Marrëveshjeje, pas konsultimit me shkrim midis datës në të cilën njoftimi i sesiionit është dërguar dhe datës në të cilën është mbajtur sesiioni.

Vëzhguesit nuk do t'i jepet e drejta t'u drejtohet sesiioneve të këshillit të anëtarëve nëse nuk autorizohet nga kryetari.

Neni 8

Aksionet e pjesëmarrjes

1. Anëtarët së bashku do të mbajnë 1000 aksione pjesëmarrjeje.

Aksionet e pjesëmarrjes do të ndahen ndërmjet anëtarëve në përpjesëtim me burimin e të dhënave të secilit anëtar, të llogaritur sipas formulës vijuese:

$$q = \frac{p_1 + e_1}{p_1 + p_2 + e_2}$$

Parametrat në këtë formulë janë mesataret e shprehura në mijëra tonë metrikë, çdo fraksion të 1000 tonëve mbi një numër të plotë që nuk merret në konsideratë.

Mundet të mos ketë fraksione të aksioneve të pjesëmarrjes.

q: të dhëna burimore të përdorura për llogaritjen proporcionale të aksioneve të pjesëmarrjes;

p₁: prodhimi mesatar i vajit të ullirit në 6 vitet e fundit të prodhimit të ullirit;

e₁: eksportet mesatare (të doganës) të vajit të ullirit në 6 vitet e fundit të vitit kalendarik që korrespondon me vitet e fundit të viteve të prodhimit të ullirit, e konsideruar për llogaritjen p₁;

p₂: prodhimi mesatar i ullinjve të tavolinës në 6 vitet e fundit të prodhimit të ullirit të konvertuar në ekuivalentin e tij të vajit të ullirit me zbatimin e një koeficienti të 16 %;

e₂: eksportet mesatare të ullinjve të tavolinës në 6 vitet e fundit kalendarike që korrespondojnë me fundin e viteve të viteve të prodhimit të ullirit e konsideruar në ekuivalentin e tyre të vajit të ullirit me aplikimin e një koeficienti konvertimi 16 për qind.

2. Megjithatë, asnjë anëtar nuk do të mbajë më pak se 5 aksione pjesëmarrjeje. Për këtë qëllim, nëse llogaritja e bazuar në paragrafin 1 do të japë një rezultat më pak se 5 aksione pjesëmarrjeje për një anëtar individual, aksioni i anëtarit do të jetë rritur në 5 dhe aksioni i pjesëmarrjes të anëtarëve të tjerë do të ulet në mënyrë proporcionale.

3. Këshilli i anëtarëve në sesiionin e tij vjetor do të miratojë aksionet e pjesëmarrjes të llogaritura në bazë të këtij neni.

Një shpërndarje e tillë do të hyjë në fuqi vitin në vijim.

4. Aksionet e pjesëmarrjes fillestare përmenden në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje. Ato përcaktohen në bazë të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, duke marrë parasysh mesataren e të dhënave për 6 vitet e fundit të prodhimit të ullirit dhe viteve kalendarike për të cilin të dhënat përfundimtare janë të disponueshme.

Çdo vit këshilli i anëtarëve do të modifikojë aksionet si të përshtatshme në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 9

Vendimet e këshillit të anëtarëve

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, vendimet e këshillit të anëtarëve do të merren me konsensusin e anëtarëve brenda një afati kohor të përcaktuar nga kryetari. Ky afat kohor nuk mund të tejkalojë kohëzgjatjen e sesiionit në të cilën projektvendimi i është paraqitur këshillit të anëtarëve.

Nëse konsensusi nuk arrihet brenda këtij afati kohor, anëtarët do të marrin një votë.

2. Çdo vendim do të jetë konsideruar i miratuar kur të paktën 50 për qind e anëtarëve që llogariten për 82 për qind të aksioneve të pjesëmarrjes janë në favor të tyre.

3. Këshilli i anëtarëve mund të marrë vendime me një shkëmbim korrespondence midis kryetarit dhe anëtarëve pa mbajtur një sesion, me kusht që të mos ketë vërejtje nga asnjë anëtar për këtë procedurë.

Rregullat për zbatimin e kësaj procedure konsultimi do të jenë hartuar nga këshilli i anëtarëve në rregullat e tij të procedurës.

Çdo vendim i marrë në këtë mënyrë do t'u komunikohet të gjithë anëtarëve nga një sekretariat ekzekutiv sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të hyjë në raportin përfundimtar të sesionit vijues të këshillit të anëtarëve.

SEKSIONI III KRYETARI DHE ZËVENDËSKRYETARI

Neni 10

Kryetari dhe zëvendëskryetari

1. Këshilli i anëtarëve do të zgjedhë një kryetar ndërmjet delegacioneve të kryetarëve.

Kryetari është kryetar i delegacionit, e drejta e tij ose e saj e pjesëmarrjes në vendimet e këshillit të anëtarëve do të ushtrohet një tjetër anëtar i delegacionit të tij ose të saj.

Pa cenuar kompetencat ose funksionet që mban drejtori ekzekutiv, ose në përputhje me këtë Marrëveshje, kryetari do të ushtrojë fuqitë ose funksionet e hartuara në këtë Marrëveshje dhe të specifikuara në rregullat e procedurës. Për rrjedhojë kryetari do të përfaqësojë Këshillin Ndërkombëtar të Vajit ligjërisht dhe do të drejtojë sesionet e këshillit të anëtarëve.

2. Këshilli i anëtarëve do të zgjedhë një zëvendëskryetar ndërmjet delegacioneve të anëtarëve. Në rastin kur zëvendëskryetari do të jetë kryetar i delegacionit, ai do të ketë të drejtën të marrë pjesë në vendimet e këshillit të anëtarëve me përjashtim të rastit kur vepron si kryetar, në rastin e të cilit ai ose ajo do t'i delegojë të drejtën një anëtar tjetër të delegacionit të tij ose të saj.

Zëvendëskryetari do të zëvendësojë kryetarin në rastin e mungesës së tij ose të saj.

3. Kryetari dhe zëvendëskryetari nuk do të marrin ndonjë shpërblim.

4. Në rastin e një mungese të përkohshme të dy kryetarëve dhe zëvendëskryetarit ose të mungesës së përhershme të njërit nga të dy, këshilli i anëtarëve do të zgjedhë nëpunës të rinj, të përkohshëm ose të përhershëm si të përshtatshëm, ndërmjet delegacioneve të anëtarëve.

SEKSIONI IV KOMITETET DHE NËNKOMITETET

Neni 11

Komiteti financiar

1. Këshilli i anëtarëve do të krijojë një komitet financiar që përfshin një delegat nga secili anëtar.

2. Komiteti financiar do të jetë përgjegjës për kontrollin financiar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe për kontrollin e zbatimit të kapitullit IV të kësaj Marrëveshjeje.

Në këtë kontekst, ai do të jetë i ngarkuar për analizimin dhe studimin e projektbuxheteve vjetore të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit propozuar nga sekretariati ekzekutiv. Vetëm projektbuxhetet që rezultojnë nga diskutimet e komitetit financiar do t'i dorëzohen këshillit të anëtarëve për miratim.

Komiteti financiar do të jetë gjithashtu përgjegjës për kontrollin e llogarive të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit në përputhje me klauzolat e nenit 18.

Çdo vit komiteti financiar do t'ia dorëzojë llogaritë për vitin e mëparshëm financiar këshillit të anëtarëve për miratim në sesionin e tij vjetor së bashku me ndonjë masë tjetër që ka të bëjë me çështjet financiare.

3. Rregullat e detajuara për zbatimin e këtyre klauzolave do të vendosen dhe miratohen nga këshilli i anëtarëve në rregullat e tij të procedurës.

Neni 12

Komitetet e tjera dhe nënkomitetet

1. Këshilli i anëtarëve mund të krijojë komitete dhe nënkomitete të tilla nëse e gjykon të dobishme për të ndihmuar në ushtrimin e funksioneve të tij nën këtë Marrëveshje.

2. Rregullat e detajuara për zbatimin e kësaj klauzole do të vendosen dhe miratohen nga këshilli i anëtarëve në rregullat e tij të procedurës. Rregullat e tilla do të:

a) sigurojnë një caktim të ndershëm të kryetarëve të komiteve ndërmjet anëtarëve të ndryshëm;

b) vendosë klauzolat që rregullojnë pranimin e vëzhguesve në takimet e komiteve dhe nënkomiteve të tij.

SEKSIONI V SEKRETARIATI EKZEKUTIV

Neni 13 Sekretariati ekzekutiv

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ketë një sekretariat ekzekutiv që përfshin një drejtor ekzekutiv, zyrtarë të lartë dhe një personel të tillë që kërkohet për të realizuar detyrat që lindin nga kjo Marrëveshje. Postet e drejtorit ekzekutiv dhe zyrtarëve të lartë do të përcaktohen në rregullat e procedurës të miratuar nga këshilli i anëtarëve.

2. Këshilli i anëtarëve do të caktojë drejtorin ekzekutiv dhe zyrtarët e lartë në bazë të parimit të alternimit proporcional ndërmjet anëtarëve dhe ekuilibrit gjeografik. Këshilli i anëtarëve do të caktojë afatin e tyre të caktimit në dritën e atyre që zbatohen për zyrtarët korrespondues të organizatave të ngjashme ndërqeveritare. Profili i tyre do të përshkruhet në rregullat e procedurës.

3. Drejtori ekzekutiv do të jetë nëpunësi përgjegjës administrativ i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Drejtori ekzekutiv do të bëjë detyrën e tij ose të saj dhe do të marrë vendime drejtimi mbi një bazë kolegjiale me zyrtarë të lartë.

4. Drejtori ekzekutiv do të caktojë personelin në përputhje me rregulloret e personelit.

5. Drejtori ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe anëtarë të tjerë të personelit nuk do të kryejnë ndonjë aktivitet fitimprurës në ndonjë sektor të ndryshëm të kultivimit të ullirit dhe industrisë së produkteve të ullirit.

6. Drejtori ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe personeli nuk do të kërkojnë ose të marrin udhëzime lidhur me detyrat e tyre nën këtë Marrëveshje nga ndonjë anëtar ose nga ndonjë autoritet i jashtëm i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Ata do të përmbahen nga çdo veprim, i cili mund të reflektojë në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë përgjegjës vetëm ndaj këshillit të anëtarëve. Anëtarët do të respektojnë në mënyrë ekskluzive karakterin ndërkombëtar të përgjegjësive të drejtorit ekzekutiv, zyrtarëve të lartë dhe personelit dhe do të shmangin ndikimin ndaj tyre në përmbushjen e përgjegjësive të tyre.

SEKSIONI VI BASHKËPUNIMI DHE MARRËDHËNIET ME ORGANIZATAT E TJERA

Neni 14 Bashkëpunimi me organizatat e tjera

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të marrë çdo masë të përshtatshme për konsultim ose bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe organet e saj, në mënyrë të veçantë me Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD), Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), Programin e Përbashkët FAO/OBSh të Komisionit të Kodex-it Ushqimor, Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), UNESCO-n dhe agjenci të tjera të specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe me organizata të tilla ndërqeveritare, qeveritare dhe joqeveritare që mund të jenë të përshtatshme për sektorin e ullirit dhe që mund të përpiqen për të siguruar fonde për të mbështetur aktivitetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për përfitimin e të gjithë anëtarëve.

2. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të vendosë marrëdhënie dhe do të përpilojë marrëveshje të veçanta bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare ose rajonale ose institucione të natyrës financiare, në veçanti me fondin e përbashkët të produkteve. Çfarëdo marrëveshje bashkëpunuese, e vendosur midis Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe organizatave ndërkombëtare të sipërpërmendura ose institucioneve, do të marrë më parë miratimin e këshillit të anëtarëve.

Në drejtim të zbatimit të çfarëdo projekti nën këtë nen, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit nuk do të mbajë, në kapacitetin e tij si një organ ndërkombëtar për produkte, ndonjë detyrim financiar për garancitë e dhëna nga anëtarë individualë ose ente të tjera. Asnjë anëtar nuk do të jetë përgjegjës për arsye të anëtarësisë së tij në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit për ndonjë përgjegjësi që lind nga marrja hua ose dhënia hua nga një anëtar tjetër ose ent në lidhje me projekte të tilla.

3. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, nëse është e nevojshme do të mbajë të informuar UNTACD-in për aktivitetet e tij dhe programet e punës duke pasur parasysh rolin e veçantë të UNTACD-it në tregtinë ndërkombëtare të produkteve.

PJESA E DYTË
KLAUZOLAT FINANCIARE

KAPITULLI IV
BUXHETET E KËSHILLIT NDËRKOMBËTAR TË ULLIRIT

Neni 15

Buxhetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

1. Këshilli i anëtarëve do të miratojë buxhetet vjetore si vijon për të arritur objektivat e përgjithshëm të parashtruar në kapitullin 1 të kësaj Marrëveshjeje:

- një buxhet administrativ;
- një buxhet të bashkëpunimit teknik;
- një buxhet promovimi.

2. Buxheti administrativ do të financohet nga kontributet e anëtarëve dhe të çfarëdo të ardhurash të tjera të gjeneruara. Sasia e kontributeve të secilit anëtar do të vendoset në përpjesëtim me aksionin e pjesëmarrjes së tij siç është hartuar në përputhje me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Buxheti i bashkëpunimit teknik do të financohet nga:

a) Sasia e kontributeve të secilit anëtar do të vendoset në përpjesëtim me aksionin e pjesëmarrjes së tij siç është hartuar në përputhje me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje;

b) Subvencionet, kontributet vullnetare të anëtarëve që do të vendosen në përpjesëtim me aksionin e pjesëmarrjes së tij siç përcaktohen në përputhje me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje;

c) Çdo e ardhur tjetër e gjeneruar.

4. Buxheti i promovimit do të financohet nga:

a) Sasia e kontributeve të secilit anëtar do të vendoset në përpjesëtim me aksionin e pjesëmarrjes së tij siç është hartuar në përputhje me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje;

b) Kontributet vullnetare të anëtarëve do të rregullohen nga klauzolat e përfshira në një marrëveshje të vendosur midis Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe anëtarit dhurues;

c) Donacionet nga qeveritë dhe/ose burime të tjera; dhe

d) Çdo e ardhur tjetër e gjeneruar.

5. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të marrë gjithashtu forma të tjera kontributesh suplementare, që përfshijnë shërbimet, pajisje teknike e shkencore dhe/ose personeli që mund të plotësojë kërkesat e programeve të miratuara. Për më tepër, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të përpiqet, si pjesë e zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, të prokurojë një asistencë financiare dhe/ose teknike që mund të merret nga komponenti i organizatave ndërkombëtare rajonale ose kombëtare, në çdo rast financiare ose të llojit tjetër. Kontributet e mësipërme do të alokohen nga këshilli i anëtarëve ose në buxhetin e bashkëpunimit teknik ose në buxhetin e promovimit ose të dy buxhetet.

6. Sasia e buxhetit administrativ, e buxhetit të bashkëpunimit teknik dhe e buxhetit të promovimit që nuk janë gjatë një viti kalendarik mund t'i kalojnë viteve vijuese kalendarike si financim parapagues i buxheteve korresponduese dhe do të jenë caktuar për atë sipas aksioneve të pjesëmarrjes së secilit anëtar për vitin kalendarik përkatës. Shuma të tilla nuk mundet, në çfarëdo rrethane, të transferohen në buxhetet të tjera nëse nuk vendos këshilli i anëtarëve.

Neni 16

Fondet administrative

Krahas buxheteve të referuara në nenin 15, Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit mund t'i jepen fonde për qëllime administrative, për të cilat janë marrë masa në rregullat e tij të procedurës.

Neni 17

Pagesa e kontributeve

1. Çdo vit, në sesionin e tij vjetor, këshilli i anëtarëve do të përcaktojë sasinë e kontributit që do të paguhet nga secili anëtar për vitin vijues kalendarik, i cili do të llogaritet në bazë të numrit të aksioneve të pjesëmarrjes që korrespondojnë për secilin anëtar siç është vendosur në bazë të nenit 8.

2. Kushtet fillestare për çdo anëtar që bëhet palë e kësaj Marrëveshjeje pas hyrjes së saj në fuqi, do të vlerësohen nga këshilli i anëtarëve. Kontributi i një anëtari të ri do të llogaritet në bazë të aksioneve të përpjesëtuara atij anëtari dhe aksioni i paskaduar i vitit në fjalë në kohën e hyrjes së anëtarit të ri, por vlerësimi i bërë për një anëtar tjetër për këtë vit nuk do të ndryshohet.

3. Kontributet e parashikuara në nenin 15 do të varen në bazë të ditës së parë të vitit kalendarik për të cilin ato janë vlerësuar. Ato do të përcaktohen në euro dhe do të jenë të pagueshme në atë valutë ose në një sasi ekuivalente të një monedhe tjetër lirisht të konvertueshme.

4. Këshilli i anëtarëve, në fillim të vitit kalendarik, do t'u kërkojë anëtarëve të shlyejnë kontributet e tyre sa më shpejt të jetë e mundur për të mundësuar Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit të operojë normalisht dhe të mundësojë zbatimin e aktiviteteve të planifikuara prej tij për vitin kalendarik përkatës. Në rast se një anëtar nuk shlyen kontributin e tij brenda gjashtë muajve nga fillimi i vitit kalendarik, këshilli i anëtarëve do ta ftojë atë të bëjë pagesën brenda tre muajve vijues. Në qoftë se këto dy afate nuk respektohen, çështja do të sillet në vëmendje të këshillit të anëtarëve në sesionet e rregullta të saj. E drejta e anëtarit për shumat e prapambetura për të marrë pjesë në vendimet e këshillit të anëtarëve dhe për të mbajtur elektorale zyrën në këshillin e anëtarëve dhe komitetin e tij dhe nënkomitetet, do të pezullohet automatikisht derisa kontributi të paguhet plotësisht. Këshilli i anëtarëve, pas dëgjimit të anëtarit me shumat e prapambetura, do të marrë një vendim tjetër të përshtatshëm, i cili do të zbatohet.

5. Asnjë vendim i këshillit të anëtarëve nuk mund të lehtësojë detyrimin e tij financiar në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 18

Kontrolli financiar

1. Kontrolli financiar i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit do të bëhet nga komiteti financiar në përputhje me nenin 11.

2. Deklarimet financiare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për vitin e mëparshëm kalendarik të certifikuar nga një revizor i pavarur do t'i paraqiten komitetit financiar, i cili, pasi i analizon llogaritë, do t'ia paraqesë ato këshillit të anëtarëve në sesionin e tij vjetor për miratim dhe botim.

Këshilli i anëtarëve do të caktojë revizorin e pavarur duke zhvilluar një tender në të cilin së paku tre firma të specializuara do të marrin pjesë. Revizori i pavarur nuk mund të caktohet për më shumë se tre vjet. Asnjë firmë e zgjedhur për auditim të llogarive të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit nuk mund të rizgjidhet për të vepruar si auditor gjatë 9 viteve vijues gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

3. Përveç kësaj, këshilli i anëtarëve në sesionin e tij vjetor do të shqyrtojë dhe miratojë raportin lidhur me:

- verifikimin e menaxhimit të fondeve, aseteve dhe parave të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;
- rregullsinë e operacioneve financiare dhe përputhshmërinë e tyre me rregullat dhe klauzolat buxhetore në fuqi.

Neni 19

Likuidimi

1. Këshilli i anëtarëve, nëse shpërmdahet, do të marrë së pari hapat e parashikuara në nenin 47, paragrafi 5.

2. Me skadimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe nëse nuk është zgjidhur, zgjeruar ose rinovuar, asetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe çfarëdo shumë e pazotuar që rrjedh nga fondet e referuara në nenin 16, si dhe shumat e pazotura të buxheteve të referuara në nenin 15, do t'u shlyhen anëtarëve në përpjesëtim me totalin e aksioneve të tyre të pjesëmarrjes në fuqi në këtë kohë. Kontributet vullnetare të referuara në nenin 15(4)(b) dhe 15(5)(b) dhe donacionet e referuara në nenin 15(5)(c) do t'i shlyhen anëtarit ose donatorit përkatës.

PJESA III
KLAUZOLAT EKONOMIKE DHE STANDARDIZIMI

KAPITULLI V
EMËRTIMET DHE PËRCAKTIMET E VAJRAVE TË ULLIRIT, VAJRAVE TË BËRSISË SË ULLIRIT
DHE ULLINJVE TË TAVOLINËS
TË DHËNA GJEOGRAFIKE

Neni 20

Përdorimi i emërimit “vaj ulliri ”

1. Emërtimi “vaj ulliri” do të jetë i kufizuar për vajrat e marra vetëm nga ulliri, me përjashtimin e vajit të ullirit të marrë nga solvent ose proceset e riesterifikimit dhe të çfarëdo përzierjeje me vajra të llojeve të tjera.

2. Në asnjë rast emërtimi “vaj ulliri” nuk do të përdoret vetëm për t’iu referuar vajrave të bërsisë së ullirit.

3. Anëtarët ndërmarrin të ndalojnë në tregtinë e tyre të brendshme dhe ndërkombëtare çfarëdo përdorimi të emërimit “vaj ulliri”, vetëm ose në kombinim me fjalë të tjera, të cilat nuk janë në përputhje me këtë nen.

Neni 21

Emërtimet dhe përcaktimet e vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës

1. Përcaktimet e kategorive të ndryshme në vijim të vajrave të ullirit dhe vajrave të bërsisë së ullirit janë përshkruar në shtojcën B:

I. Vaj ulliri

A. Vajra ulliri verxhin

a) vaj ulliri verxhin i përshtatshëm për konsum siç janë ato:

i) vaj extra verxhin;

ii) vaj ulliri verxhin ;

iii) vaj ulliri i zakonshëm verxhin;

c) vaj ulliri verxhin që nuk është i përshtatshëm për konsum siç janë ato:

d) vaj ulliri verxhin lampant;

e) vaj ulliri i rafinuar;

f) (C) vaj ulliri;

g) (II) vaj bërsie ulliri;

h) (A) vaj ulliri bërsie i papërpunuar;

i) (B) vaj bërsie ulliri i rafinuar;

j) (C) vaj bërsie ulliri.

2. Përcaktimet e tipeve vijuese të ullinjve për tavolinë janë përshkruar në shtojcën C:

i) ullinj jeshil;

ii) ullinjtë që ndryshojnë ngjyrë;

iii) ullinjtë e zinj.

3. Këshilli i anëtarëve mund të bëjë të gjitha amendamentet e tilla që ai gjykon të nevojshme ose të përshtatshme për kategoritë e vajrave dhe tipet e ullinjve të tavolinës siç jepen në këtë nen dhe në përcaktimet e hartuara në shtojcat B dhe C.

Neni 22

Sipërmarrjet nga anëtarët

1. Anëtarët e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit ndërmarrin të zbatojnë përcaktimet e përshkruara në shtojcat B dhe C në tregtinë ndërkombëtare dhe do të nxisin zbatimin e tyre në tregtinë e tyre të brendshme.

2. Këshilli i anëtarëve do të përcaktojë standardet e kritereve të cilësisë të aplikueshme në tregtinë ndërkombëtare të anëtarëve, në përputhje me nenin 25 paragrafi 3.

3. Anëtarët ndërmarrin të analizojnë në detaje përcaktimin e emërtimeve dhe të të dhënave gjeografike që mund të jetë me interes ekonomik për anëtarët, si dhe gjithashtu klauzolat minimale

kombëtare ligjore të kërkuara për të siguruar mbrojtjen e të dhënave të tilla. Për këtë qëllim, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të sigurojë mjetet për të zhvilluar një skemë reciproke njohjeje për të dhëna të tilla.

4. Të dhënat gjeografike, kur jepen, mund të aplikohen vetëm për vajrat e ullirit verxhine dhe për ullinjtë e tavolinës që i përkasin kategorisë së tregtisë ekstra, të cilat janë prodhuar në përputhje me klauzolat përkatëse për këto produkte.

5. Të dhënat gjeografike mund të përdoren vetëm në përputhje me kushtet e përshkruara nga ligji i vendit të origjinës.

6. Anëtarët ndërmarrin, në veçanti, të zhvillojnë një skemë për njohjen reciproke të të dhënave gjeografike për të siguruar mbrojtjen kryesisht të të dhënave gjeografike të mbrojtura nën ligjin kombëtar të anëtarëve, dhe të ndalojnë dhe të kufizojnë përdorimin në territorin e tyre, për qëllimet e tregtisë ndërkombëtare, të të dhënave të tilla gjeografike dhe emërtimeve të vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës si konflikt me këto parime.

Kjo sipërmarrje do të zbatohet për të gjitha mbishkrimet e vendosura në shënimet e paketimeve, faturave, dërgesave dhe dokumenteve tregtare ose të përdorura në reklama dhe markat tregtare, emrat e regjistruar dhe ilustrimet e lidhura me marketingun ndërkombëtar të vajrave të ullirit, vajrave të bërsive të ullirit dhe ullinjve të tavolinës, nëse mbishkrime të tilla mund të përmbajnë deklarime të rreme ose të shkaktojnë konfuzion si për origjinën, burimin ose cilësinë e vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit ose ullinjve të tavolinës përkatës.

Neni 23

Mosmarrëveshjet dhe pajtimi

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me të dhënat gjeografike që lindin nga interpretimi i klauzolave të këtij kapitulli ose nga vështirësitë në zbatimin e tyre, nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet me negociim direkt, do të shqyrtohet nga këshilli i anëtarëve.

2. Këshilli i anëtarëve do të përpiqet të pajtojë mosmarrëveshjen, pasi të kërkojë opinionin e një paneli këshillimor siç jepet në nenin 37, paragrafi 1 dhe pas konsultimit me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, me një organizatë kompetente profesionale dhe nëse është e nevojshme, me Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë dhe institucionet e specializuara ndërkombëtare për kiminë analitike, nëse kjo nuk është e suksesshme, dhe pasi këshilli i anëtarëve ka përcaktuar që çdo mjet është përdorur për të arritur marrëveshjen, anëtarët e interesuar do të kenë të drejtën e rekursit në shkallën e fundit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

KAPITULLI VI

STANDARDIZIMI I TREGJEVE PËR PRODUKTET E ULLIRIT

Neni 24

Shqyrtimi i situatës dhe i zhvillimeve në tregun e vajit të ullirit, vajit të bërsive të ullirit dhe ullinjve të tavolinës

1. Në kuadër të objektivave të përgjithshëm të parashtruar në nenin 1, dhe me qëllim që të kontribuohet drejt standardizimit të tregut të vajit të ullirit, vajit të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës dhe për të ndrequr çfarëdo disekuilibri midis furnizimit ndërkombëtar dhe kërkesës si rezultat i çrregullimit të vjeljes ose faktorëve të tjerë, anëtarët do t'i venë në dispozicion dhe do t'i japin Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit të gjitha të dhënat, statistikën e nevojshme dhe dokumentacionin për vajin e ullirit, vajin e bërsive të ullirit dhe ullinjve të tavolinës.

2. Këshilli i anëtarëve në sesionin e tij vjetor do të bëjë një shqyrtim të detajuar të bilanceve të produkteve të ullirit dhe një vlerësim të përgjithshëm të furnizimeve dhe të kërkesës për vajin e ullirit, vajin e bërsive të ullirit dhe ullinjve të tavolinës, në bazë të informacionit të dhënë nga secili anëtar sipas nenit 36, të çfarëdo informacioni të komunikuar Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit nga qeveritë e shteteve jo palë të kësaj Marrëveshjeje, dhe çfarëdo materiali tjetër përkatës në dispozicion të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për sa më sipër. Këshilli i anëtarëve do të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e vënë në dispozicion për të, do të shqyrtojë gjendjen e tij dhe do të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të furnizimeve dhe kërkesës për të gjitha produktet e ullirit dhe mund t'u propozojë anëtarëve masa të tilla që i konsideron të dëshirueshme.

Neni 25

Standardizimi i tregjeve për produktet e ullirit

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ndërmarrë studime, me qëllim që t'u bëjë rekomandime anëtarëve për arritjen e një ekuilibri midis prodhimit dhe konsumit, dhe përgjithësisht, për standardizimin e tregut për prodhimet e ullirit në planin afatgjatë nëpërmjet zbatimit të masave të përshtatshme.

2. Me qëllim një standardizim të tillë, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ndërmarrë gjithashtu studime për t'u rekomanduar anëtarëve zgjidhje të përshtatshme për problemet që mund të lindin lidhur me evoluimin e tregut ndërkombëtar për vajin e ullirit, vajin e bërësive të ullirit dhe ullinj të tavolinës, nëpërmjet masave të përshtatshme, llogaritë të jenë marrë për disekuilibrat e tregut që rezultojnë nga luhatjet në prodhim ose nga shkaqe të tjera.

3. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të shqyrtojë rrugët dhe mjetet që sigurojnë zgjerimin e tregut ndërkombëtar dhe rritjen e konsumit të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës. Në mënyrë të veçantë ai do t'u bëjë rekomandime të përshtatshme anëtarëve të tjerë lidhur me:

a) miratimin dhe përdorimin e një kontrate tip ndërkombëtare për transaksionet në vajrat e ullirit, vajrat e bërësive të ullirit dhe ullinj të tavolinës;

b) krijimin dhe funksionimin e një pajtimi ndërkombëtar dhe zyre arbitrazhi për t'u marrë me çfarëdo mosmarrëveshje që lidhet me transaksionet në vajrat e ullirit, vajrat e bërësive të ullirit dhe ullinj të tavolinës;

c) zbatimin e standardeve për karakteristikat fizike, kimike dhe organoleptike të vajrave të ullirit, vajrave të bërësive të ullirit dhe ullinjve të tavolinës;

d) vendosjen e metodave uniforme të analizës.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të marrë çfarëdo mase që e konsideron të dobishme për eliminimin e konkurrencës në pandershmëri në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë një konkurrencë të tillë nga shtete që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje ose nga persona të cilët janë shtetas të shteteve të tilla.

PJESA E KATËRT

KLAUZOLAT TEKNIKE

KAPITULLI VII

BASHKËPUNIMI TEKNIK NË SEKTORIN E ULLIRIT

Neni 26

Programet dhe aktivitetet

1. Me qëllim arritjen e objektivave të përgjithshme të parashtruara në nenin 1 që kanë të bëjnë me bashkëpunimin teknik në lidhje me ullinj të ndërpunimit të ullirit, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, që vepron nëpërmjet këshillit të tij të anëtarëve do të hartojë, promovojë dhe përpunojë programet e aktiviteteve që lidhen me to.

2. Ky bashkëpunim teknik do të përfshijë kultivimin e ullirit, ekstraktimin e vajit të ullirit dhe industrinë e ullinjve për tavolinë.

3. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të marrë veprim të drejtpërdrejtë për të promovuar një bashkëpunim të tillë teknik.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të vendosë që të kërkojë bashkëpunimin e organeve publike ose private ose enteve kombëtare ose ndërkombëtare, për të zbatuar pjesë ose të gjitha klauzolat e këtij kapitulli. Ai mund të japë gjithashtu një kontribut financiar për organet e sipërpërmendura dhe ose/ato që lidhen brenda kufijve të buxhetit.

Neni 27

Kërkimi dhe zhvillimi

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit duke vepruar nëpërmjet këshillit të tij të anëtarëve do të shqyrtojë çfarëdo propozim për projekte kërkim-dhe-zhvillimi të një interesi të përgjithshëm për anëtarët dhe do të marrë masa të tilla që janë të përshtatshme në këtë fushë.

2. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të kërkojë bashkëpunimin e instituteve kërkimore të specializuara, laboratorëve dhe qendrave për zbatimin, monitorimin, përdorimin dhe përhapjen me përfitim

të anëtarëve, të rezultateve të programeve kërkimore dhe të zhvillimit.

3. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të ndërmarrë studimet e nevojshme për përfitim ekonomik që mund të pritet nga zbatimi i rezultateve të programeve të kërkimit dhe të zhvillimit

Neni 28

Trajnimet dhe operacionet specifike

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, duke vepruar nëpërmjet këshillit të tij të anëtarësisë, do të marrë hapat e nevojshme për organizimin e kurseve rifreskuese të trajnimit në nivele të ndryshme për ekspertët teknikë në sektorin e ullirit, në veçanti për ata anëtarë që janë në vendet në zhvillim.

2. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të inkurajojë transferimin e teknologjive të anëtarëve që janë në vendet në zhvillim nga anëtarët mjaft të avancuar në kultivimin e ullirit, ekstraktimin e vajit të ullirit dhe teknikat e përpunimit të ullinjve të tavolinës.

3. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të lehtësojë çfarëdo bashkëpunimi teknik që mundëson konsulentët dhe ekspertët të vihen në dispozicion të anëtarëve që kërkojnë shërbime të tilla.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të lehtësojë pjesëmarrjen e delegacioneve dhe ekspertëve të anëtarëve në takimet e tij të përgjithshme ose takimet shkencore-teknike.

5. Në veçanti, këshilli i anëtarëve do të:

a) kryejë studime specifike dhe operacione;

b) thërrasë ose nxisë zhvillimin e seminareve ndërkombëtare dhe takimeve;

c) mbledhë informacion teknik dhe do ta qarkullojë atë tek të gjithë anëtarët;

d) promovojë bashkërendimin e aktiviteteve që lidhen me bashkëpunimin teknik ndërmjet anëtarëve në kultivimin e ullirit, ekstraktimin e vajit të ullirit dhe industrisë së ullinjve të tavolinës duke përfshirë veprime brenda kuadrit të planifikimit ndërrajonal ose rajonal;

e) promovojë bashkëpunime të tilla dypalëshe ose shumëpalëshe që mund ta ndihmojnë Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit në arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII MASA TË TJERA

Neni 29

Masa të tjera

Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të:

a) nxisë dhe bashkërendojë studime të përshtatshme dhe kërkime për vlerën biologjike të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës, me referencë të veçantë për cilësitë e tyre ushqyese dhe veti të tjera të qenësishme;

b) hartojë së bashku me organe specialistësh, terminologjinë që lidhet me ullirin, standardet që mbulojnë produktet e ullirit dhe metodat e analizave, si dhe standarde të tjera që lidhen me sektorin e ullirit.

c) marrë çfarëdo masash që janë të përshtatshme për të hartuar një konspekt të vendosjes së praktikave të ndershme tregtare për tregtinë ndërkombëtare me vajin e ullirit, vajin e bërsive të ullirit dhe ullinjtë e tavolinës.

PJESA E PESTË KLAUZOLA PROMOVUESE

KAPITULLI IX PROMOVIMI BOTËROR I KONSUMIT TË VAJIT TË ULLIRIT DHE ULLINJVE PËR KONSUM

Neni 30

Programet për të promovuar konsumin e vajit të ullirit dhe ullinjve për konsum

1. Anëtarët do të ndërmarrin bashkërisht të zhvillojnë veprimtari të përgjithshme promovuese për të rritur konsumin botëror të vajit të ullirit dhe ullinjve, në bazë të përdorimit të caktimit përkatësisht të vajit të ullirit të ngrënë dhe ullinjve për konsum të përcaktuar në shtojcat B dhe C.

2. Këto veprimtari do të marrin formën e fushatave edukative dhe informative dhe do të kenë të bëjnë me karakteristikat organoleptike dhe kimike të vajit të ullirit dhe ullinjve për konsum, si dhe me vetitë e tyre ushqyese, teraupetike dhe veçori të tjera.

3. Fushatat promovuese kanë qëllim të informojnë konsumatorët rreth emërtesave, origjinave dhe burimeve të vajrave të ullirit dhe ullinjve për konsum, duke bërë kujdes që të sigurohet që as për cilësinë, origjinën ose burimin të mos promovohet ose jepet përparësi në preferencë të një tjetri.

4. Programet e promovimit që do të ndërmerren nën këtë nen do të vendosen nga këshilli i anëtarëve në dritën e burimeve të bëra të përdorshme për të.

Përparësi do t'i jepet veprimit kryesisht në vendet konsumuese dhe në ato vende në të cilat konsumi i vajit të ullirit dhe ullinjve për konsum ka të ngjarë të rritet.

5. Burimet e buxhetit të promovimit do të përdoren në dritën e kriterëve vijuese:

a) volumni i konsumit dhe mundësitë e zhvillimit të tregjeve ekzistuese;

b) krijimi i tregjeve të reja për vajin e ullirit dhe ullinjtë për konsum;

c) të ardhurat e marra nga shpenzimet e promovimit.

6. Këshilli i anëtarëve do të administrojë të gjitha burimet e alokuara për qëllime të përbashkëta promovimi. Ai do të përgatisë një vlerësim vjetor të faturave dhe shpenzimeve që lidhen me këtë promovim si një shtojcë e buxhetit të tij.

7. Në rastin e një anëtar, organizate ose personi që jep kontribut vullnetar për kryerjen e veprimit promovues, këshilli i anëtarëve do të miratojë procedura që rregullojnë përdorimin e burimeve të tilla brenda kuadrit të një marrëveshjeje specifike midis Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe kontribuesve.

8. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të jetë përgjegjës për ekzekutimin teknik të programeve promovuese, të cilat mund t'u besohen, gjithashtu organeve të specializuara të zgjedhura në përputhje me rregullat e procedurës.

Neni 31

Etiketa e garantuar ndërkombëtare e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

Këshilli i anëtarëve mund të marrë masa për zbatimin e etiketës ndërkombëtare të garancisë së cilësisë duke siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

PJESA E GJASHTË KLAUZOLA TË TJERA

KAPITULLI X DETYRIME TË NDRYSHME

Neni 32

Detyrime të përgjithshme

Anëtarët nuk zotohen të miratojnë ndonjë masë që nuk pajtohet me detyrimet e tyre nën këtë Marrëveshje ose me objektivat e përgjithshëm të parashtruar në nenin 1.

Neni 33

Detyrimi financiar i anëtarëve

Në përputhje me parimet e përgjithshme të ligjit, detyrimi financiar i secilit anëtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe anëtarëve të tjerë kufizohet në shkallën e detyrimeve të tij në bazë të nenit 15 që lidhet me kontributet për buxhetet e referuara në të njëjtin nen dhe nëse sipas rastit, në bazë të nenit 16 që i referohet fondeve administrative.

Neni 34

Aspektet mjedisore dhe ekologjike

Anëtarët duhet të kenë në konsideratë të gjitha aspektet mjedisore dhe ekologjike në të gjitha fazat e prodhimit të ullirit dhe të vajit të ullirit dhe marrin përsipër të zbatojnë veprime të tilla që mund të gjykojnë të nevojshme nga këshilli i anëtarëve për të përmirësuar ose zgjidhur çfarëdo problemi që ka të bëjë me këtë sferë.

Neni 35

Nxitja e tregtisë ndërkombëtare dhe konsumit

Anëtarët marrin përsipër të miratojnë të gjithat masat e përshtatshme për të lehtësuar tregtinë, të nxisin konsumin e vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës dhe të sigurojnë zhvillimin e rregullt të tregtisë ndërkombëtare në këto produkte. Për këtë qëllim ato marrin përsipër të pajtohen me parimet, rregullat dhe udhëzimet që kanë miratuar në forume kompetente ndërkombëtare.

Neni 36

Informacioni

Anëtarët marrin përsipër t'i vënë në dispozicion dhe t'i japin Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit të gjitha statistikave, të dhënat dhe dokumentacionin që i nevojitet atij në përmbushjen e funksioneve të tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë çfarëdo informacioni që ai kërkon për të vendosur ekuilibrat për vajrat e ullirit, vajrat e bërësisë së ullirit dhe për të pasur njohuri për politikën kombëtare të anëtarëve për produktet e ullirit.

KAPITULLI XI

MOSMARRËVESHJET DHE ANKIMIMET

Neni 37

Mosmarrëveshjet dhe ankimimet

1. Çfarëdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje e ndryshme nga një mosmarrëveshje sipas nenit 23, dhe e cila nuk është zgjidhur me negociim, me kërkesën e palës që është palë e mosmarrëveshjes, do t'i referohet këshillit të anëtarëve, i cili do të marrë një vendim në mungesë të anëtarit përkatës, pasi ka kërkuar një opinion, dhe kur është e përshtatshme nga një panel këshillimor, përbërë dhe detajet operative të së cilit do të parashtrihen në rregullat e procedurës.

2. Një opinion i bazuar nga paneli këshillimor do t'i paraqitet këshillit të anëtarëve, i cili në të gjitha rrethanat do të zgjidhë mosmarrëveshjen pasi të ketë shqyrtuar të gjitha faktet përkatëse.

3. Çdo ankimim që një anëtar ka dështuar të plotësojë detyrimin e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje, me kërkesën e anëtarit që bën ankimimin, do t'i referohet këshillit të anëtarëve, i cili do të marrë një vendim në mungesë të anëtarit në fjalë pas konsultimit të anëtarëve përkatës dhe pas kërimit të një opinionit, kur është e përshtatshme, nga paneli këshillimor që i referohet paragrafit 1 të këtij neni.

4. Nëse këshilli i anëtarëve konstaton që një anëtar ka kryer një shkelje të kësaj marrëveshjeje, ai mundet gjithashtu t'i ngarkojë sanksione që variojnë nga një paralajmërim i thjeshtë për pezullimin e së drejtës së anëtarit për të marrë pjesë në vendimet e këshillit të anëtarëve deri sa ai të ketë plotësuar detyrimet e tij, ose në përputhje me procedurën e hartuar nën nenin 45, përjashton anëtarin nga pjesëmarrja në Marrëveshje.

Anëtarë në fjalë do të ketë të drejtën e rekursit në shkallën e fundit, në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë.

KAPITULLI XII

KLAUZOLA PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Depozitari

Qeveria e Spanjës është caktuar si depozitare e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 39

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi dhe miratimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim në Madrid me Qeverinë e Spanjës nga data 15 qershor deri më 31 dhjetor 2005 përfshirë qeveritë e ftuara në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për negociimin e një marrëveshjeje pasardhëse për Marrëveshjen Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjë të Tavolinës, 1986, e amenduar dhe e zgjeruar, 1993.

2. Çdo qeveri e referuar në paragrafin 1 të këtij neni mundet:
a) në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, të deklarojë që me një nënshkrim të tillë ajo shpreh pëlqimin të lidhet me këtë Marrëveshje (nënshkrimi përfundimtar); ose
b) pas nënshkrimit të Marrëveshjes, ratifikon, pranon ose e miraton atë nëpërmjet depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim te depozitari.

Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim, ratifikim, pranim ose miratim nga Komuniteti European.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimi ose miratimi do të depozitohen pranë depozitarit.

Neni 40

Aderimi

1. Çdo shtet mund të aderojë në këtë Marrëveshje me kushtet e vendosura nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, që vepron nëpërmjet këshillit të anëtarëve, i cili do të përfshijë një numër aksionesh pjesëmarrjeje dhe një afat kohor për depozitim të instrumenteve të aderimit. Këshilli i anëtarëve mundet megjithatë, të zgjasë afatet kohore për qeveritë të cilat nuk janë në gjendje të pranojnë afatin kohor të vendosur në kushtet e aderimit.

Pas aderimit, një shtet do të çmohet që të renditet në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me aksionet e pjesëmarrjes të parashtruara në kushtet e aderimit.

Neni 41

Njoftimi i zbatimit të përkohshëm

1. Një qeveri nënshkruese, e cila synon ta ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Marrëveshje ose një qeveri, për të cilën këshilli i anëtarëve ka vendosur kushtet për aderim, por i cili nuk është në gjendje të depozitojë instrumentin e tij, mundet, në çfarëdo kohe ta njoftojë depozitarin që ai ta zbatojë këtë Marrëveshje në mënyrë të përkohshme kur ajo hyn në fuqi në përputhje me nenin 42 ose nëse ajo është tashmë në fuqi, në një datë të specifikuar.

2. Një qeveri e cila ka njoftuar në bazë të paragrafit 1 të këtij neni që ajo do ta zbatojë këtë Marrëveshje kur hyn në fuqi, ose, nëse ajo është tashmë në fuqi, në një datë të specifikuar, nga kjo kohë do të jetë një anëtar i përkohshëm deri sa të depozitojë instrumentin e saj të ratifikimit, pranimi, miratimi ose aderimit dhe kështu bëhet një anëtar.

Neni 42

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi përfundimisht ditën kur të paktën 5 qeveri ndërmjet atyre të përmendura në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje, dhe duke llogaritur të paktën 90 për qind të aksioneve të pjesëmarrjes, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht ose e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë, ose kanë aderuar në të.

2. Nëse më 1 janar të vitit 2006 kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ajo do të hyjë në fuqi në mënyrë të përkohshme në qoftë se nga kjo datë 5 qeveri që plotësojnë kërkesat e përqindjes të paragrafit 1 të këtij neni kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht ose e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë ose kanë njoftuar depozitarin që ato do ta zbatojnë këtë Marrëveshje në mënyrë të përkohshme.

3. Nëse më 1 janar të vitit 2006, kërkesat për hyrjen në fuqi në bazë të paragrafit 1 ose paragrafit 2 të këtij neni nuk janë plotësuar, depozitari do t'i ftojë ato qeveri që e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht ose e kanë ratifikuar, pranuar ose miratuar atë, ose kanë njoftuar që do ta zbatojnë këtë marrëveshje në mënyrë të përkohshme, të vendosin nëse do ta sjellin këtë Marrëveshje në fuqi përfundimisht ose në mënyrë të përkohshme ndërmjet tyre, tërësisht ose pjesërisht, në një datë që mund të caktojnë.

4. Për çdo qeveri e cila nuk ka njoftuar depozitarin në bazë të nenit 41 që ajo do ta zbatojë këtë Marrëveshje në mënyrë të përkohshme dhe për të cilën depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit.

Neni 43
Amendimi

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, duke vepruar nëpërmjet këshillit të anëtarëve, mund t'u rekomandojë anëtarëve amendime të kësaj Marrëveshjeje.

2. Amendamenti i propozuar do të miratohet nga këshilli i anëtarëve, në përputhje me nenin 9 të Marrëveshjes dhe do të hyjë në fuqi për të gjithë anëtarët 90 ditë pasi depozitari të ketë marrë njoftimin e vendimit të këshillit të anëtarëve.

Neni 44
Tërheqja

1. Çdo anëtar mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çfarëdo kohe pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke i dhënë njoftim me shkrim depozitarit. Anëtari do ta informojë njëkohësisht me shkrim Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit për veprimin që ai ka marrë.

2. Tërheqja në bazë të këtij neni do të bëhet efektive 90 ditë pasi njoftimi të jetë marrë nga depozitari.

Neni 45
Përfundimi

Pa cenuar nenin 37, nëse këshilli i anëtarëve vendos që çdo anëtar është në shkelje të detyrimit të tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe vendos më tej që kjo shkelje cenon në shkallë të konsiderueshme operacionin e kësaj Marrëveshjeje, mundet, me vendim të arsyetuar të anëtarëve të tjerë, të marrë në mungesë të anëtarit të interesuar, ta përjashtojë atë anëtar nga kjo Marrëveshje. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do ta njoftojë menjëherë depozitarin për vendimin e tij.

Anëtari në fjalë do të pushojë së qeni palë e kësaj Marrëveshjeje 30 ditë pas datës së vendimit të këshillit të anëtarëve.

Neni 46
Shlyerja e llogarive

1. Këshilli i anëtarëve do të përcaktojë çfarëdo shlyerje të llogarive, të cilat ai i çmon të barasvlefshme, duke marrë në konsideratë të gjitha angazhimet që përfshijnë pasoja ligjore për Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit dhe që do të ketë pasoja në kontributet e një anëtarit i cili është tërhequr nga kjo Marrëveshje ose është përjashtuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, ose përndryshe ka pushuar së qeni palë e kësaj Marrëveshjeje, si dhe gjithashtu koha e nevojitur për të siguruar një tranzicion të mjaftueshëm, në veçanti kur angazhime të tilla kanë përfunduar.

Pavarësisht nga klauzolat e nënparagrafëve të mësipërm një anëtar i tillë do të jetë i detyruar të paguajë çfarëdo shume që i detyrohet Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit lidhur me periudhën gjatë së cilës ai ka qenë anëtar.

2. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, asnjë anëtar, të referuar në paragrafin 1 të këtij neni, nuk do t'i jepet e drejta për ndonjë pjesë të të ardhurave të likuidimit ose asete të tjera të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, ose do të ngarkohet me ndonjë pjesë të defiçitit, nëse ka, të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

Neni 47
Kohëzgjatja, zgjatja, zgjerimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbesë në fuqi deri më 31 dhjetor 2014, nëse Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit që vepron nëpërmjet këshillit të anëtarëve, nuk vendos ta zgjasë atë, ta zgjerojë, ta rinovojë ose ta përfundojë përpara në përputhje me klauzolat e këtij neni.

2. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit duke vepruar nëpërmjet këshillit të tij të anëtarëve, mund të

vendosë ta zgjasë këtë Marrëveshje jo më shumë se dy periudha prej dy vitesh secila. Çdo anëtar i cili nuk pranon ndonjë zgjatje të tillë të kësaj Marrëveshjeje do ta informojë Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit dhe do të pushojë së qeni Palë e kësaj Marrëveshjeje nga fillimi i periudhës së zgjatjes.

3. Nëse para 31 dhjetorit të vitit 2014 ose përpara përfundimit të një periudhe zgjatjeje të referuar në paragrafin 2 të këtij neni, sipas rastit, një marrëveshje e re ose një protokoll për zgjerimin e kësaj Marrëveshjeje është negociuar, por nuk ka hyrë në fuqi ose përfundimisht ose në mënyrë të përkohshme, kjo Marrëveshje do të mbesë në fuqi përtej datës së saj të përfundimit derisa një marrëveshje e re ose protokoll hyn në fuqi, me kusht që periudha e një zgjatjeje të tillë të mos tejkalojë 12 muaj.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit që vepron nëpërmjet këshillit të anëtarëve, mundet në çdo kohë të vendosë ta përfundojë këtë Marrëveshje me fuqi nga kjo datë, siç mund të jetë përcaktuar.

5. Pavarësisht skadimit ose përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të vazhdojë të jetë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimin e kryerjes së likuidimit të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, duke përfshirë shlyerjen e llogarive, dhe do të ketë për një periudhë të tillë kompetencat dhe funksionet që mund të jenë të nevojshme për këto qëllime.

6. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do ta njoftojë depozitarin për çdo vendim të marrë sipas këtij neni.

Neni 48 Rezervat

Nuk do të bëhet asnjë rezervë në lidhje me ndonjë prej klauzolave të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi sa më sipër, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar rregullisht, kanë vendosur nënshkrimin e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje në datat e specifikuara.

Bërë në Gjenevë më 29 prill 2005, ndërsa tekstet e kësaj Marrëveshjeje në gjuhën arabe, angleze, frënge, italiane dhe spanjolle janë njëllor autentike.

Algjeria	13
Komuniteti European	783
Kroacia	5
Egjipti	9
Irani (Republika Islamike e)	5
Izraeli	5
Libia	5
Jordania	8
Libani	5
Maroku	27
Mali i Zi	5
Republika Arabe e Sirisë	52
Serbia	5
Tunizia	73
Totali.1 000	

SHTOJCA A

Aksionet e pjesëmarrjes në buxhetet e organizatës, të vendosura në përputhje me nenin 8⁶

SHTOJCA B

Emërtimet dhe përcaktimet e vajrave të ullirit dhe vajrave të bërsisë së ullinjve

Emërtimet e kategorive të ndryshme të vajrave të ullirit dhe vajrave të bërsisë së ullirit janë dhënë më poshtë me përcaktimin korrespondues të çdo emërtimi.

⁶ Llogaritjet janë bazuar në prodhimin mesatar për periudhën 1999/2000 -2004/2005 dhe në mesataren e eksporteve për periudhën 2000-2005.

I. Vaj ulliri është vaji që merret vetëm nga fruti i pemës së ullirit, me përjashtimin e vajrave që merren duke përdorur solvent ose procese riesterifikimi dhe çfarëdo përzierje me vajra të llojeve të tjera. Ai është emërtuar si vijon:

A. Vaj ulliri verxhin: vajra të cilat janë marrë nga fruti i pemës së ullirit vetëm nga mjete mekanike ose të tjera fizike nën kushte të veçanta termale që nuk të çojnë në prishjen e vajit dhe të cilat nuk i janë nënshtruar ndonjë përpunimi veçse larjes, dekantimit, centrifugimit dhe filtrimit. Vajrat e ullirit verxhin do të klasifikohen dhe emërtohen si vijon:

a) Vajrat verxhin të përshtatshme për konsum ashtu siç janë:

i) Vaj ulliri ekstra verxhin: vaj ulliri verxhin, i cili ka një aciditet të lirë, shprehur në acide oleik, jo më shumë se 0.8 gram për 100 gram dhe karakteristika të tjera që korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori;

ii) Vaj ulliri verxhin: Vaj ulliri verxhin, i cili ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik jo më shumë se 2.0 gram për 100 gram dhe karakteristika të tjera të cilat korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori;

iii) Vaj ulliri verxhin i zakonshëm: vaj ulliri verxhin i cila ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 3.3 gram për 100 gram dhe karakteristika të tjera të cilat korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori⁷.

b) Vaj ulliri verxhin që nuk përshtaten për konsum ashtu siç janë:

Vaj ulliri verxhin lampant: vaj ulliri verxhin, i cili ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, më shumë se 3.3 gram për 100 gram dhe /ose karakteristikat organoleptike dhe karakteristikat e tjera të cilat korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori. Ai përdoret për rafinim, për t'u përdorur për konsum njerëzor ose për përdorim teknik,

B. Vaj ulliri i rafinuar: vaj ulliri i marrë nga rafinimi i vajrave verxhin.

Ai ka një aciditet të lirë të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 0.3 gram për 100 gram dhe karakteristikat e tij të tjera i korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori⁸.

C. Vaj ulliri: vaj që përbëhet nga një përzierje vaji ulliri dhe vajra ulliri të përshtatshëm për konsum siç janë. Ai ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik jo më shumë se 1 gram për 100 gram dhe karakteristikat e tjera të tij korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori⁹.

II. Vaj bërserie ulliri është vaji i marrë nga përpunimi i bërserieve të ullirit me solvent ose trajtime të tjera fizike, me përjashtimin e vajrave të marra nga proceset e riesterifikimit dhe të çfarëdo përzierjeje me vajra të llojeve të tjera. Ai klasifikohet si vijon :

A. Vaj bërserie ulliri i papërpunuar: vaj bërserie ulliri, karakteristikat e të cilit janë hartuar për këtë kategori. Ai është destinuar për rafinim, për përdorim, për konsum njerëzor ose i destinuar për përdorim teknik.

B. Vaj bërserie ulliri i rafinuar: vaj i marrë nga rafinimi i vajit të papërpunuar të bërserieve të ullirit. Ai ka një aciditet të lirë të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 0.3 gram për 100 gram dhe karakteristikat e tij të tjera korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori¹⁰.

C. Vaj bërserie ulliri :vaj që përbëhet nga një përzierje e vajit të bërserieve të ullirit të rafinuar dhe vajrave të ullirit verxhin që është i përshtatshëm për konsum ashtu siç janë. Ai ka një aciditet të lirë, të shprehur si acid oleik, jo më shumë se 1 gram për 100 gram dhe karakteristikat e tjera korrespondojnë me ato të hartuara për këtë kategori.

Në asnjë rast kjo përzierje nuk do të quhet "vaj ulliri."¹¹

SHTOJCA C TIPET DHE PËRKUFIZIMET E ULLINJVE TË TAVOLINËS

Ullinj të tavolinës do të klasifikohen në një nga tipet e mëposhtme.

i) Ullinj jeshil: frutat e vjelura gjatë periudhës së pjekjes para ngjyrosjes dhe kur ato kanë arritur madhësinë normale. Ato mund të ndryshojnë në ngjyrë nga jeshile në ngjyrën e verdhë të kashtës.

ii): Ullinj që ndryshojnë ngjyrë: frutat e vjelura para fazës së pjekjes së plotë është arritur, me ndryshim ngjyre. Ato mund të ndryshojnë në ngjyrë nga rozë në ngjyrë rozë vere ose kafe.

⁷ Ky produkt mund t'i shitet drejtpërdrejt konsumatorit vetëm nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë.

Nëse nuk lejohet, emërtimi i këtij produkti duhet të pajtohet me dispozitat ligjore të vendit të interesuar.

⁸ Ky produkt mund t'i shitet drejtpërdrejt konsumatorit vetëm nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë.

⁹ Vendi i shitjes me pakicë mund të kërkojë një emërtim më specifik.

¹⁰ Ky produkt mund t'i shitet drejtpërdrejt konsumatorit vetëm nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë.

¹¹ Vendi i shitjes me pakicë mund të kërkojë një emërtim më specifik.

iii) Ullinjtë e zinj: frutat e vjelura kur janë plotësisht të pjekura para arritjes së pjekjes së plotë. Ato mund të ndryshojnë në ngjyrë nga e kuqe në të zezë në ngjyrë vjollcë e zezë, ngjyrë vjollcë e thellë, e zezë në jeshile ose ngjyrë gështenjë e thellë.

LIGJ
Nr.10 030, datë 11.12.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacioneve të klasifikuara”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5981, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR MBROJTJEN RECIPROKE TË INFORMACIONEVE TË KLASIFIKUARA

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, *me synimin* për të garantuar mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, të cilat shkëmbehen midis autoriteteve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës Federale të Gjermanisë, si dhe me kontraktues në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese ose midis kontraktuesish të të dyja Palëve Kontraktuese,

të shtyra nga dëshira për të krijuar dispozita ligjore për mbrojtjen reciproke të informacioneve të klasifikuara, të cilat gjejnë zbatim në të gjitha marrëveshjet për bashkëpunim dhe në kontratat, të cilat sjellin me vete një shkëmbim të informacioneve të klasifikuara,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizime

1) Sipas kuptimit të kësaj Marrëveshjeje

1. Informacione të klasifikuara janë:

a) në Republikën e Shqipërisë:

“Sekret shtetëror” do të thotë informacion i klasifikuar, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar.

“Sigurim kombëtar” do të thotë mbrojtja e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë dhe marrëdhënieve të saj me vende të huaja;

b) në Republikën Federale të Gjermanisë:

fakte, objekte ose njohuri që duhen mbajtur sekret në interesin publik, pavarësisht nga forma e

paraqitjes së tyre. Në përputhje me nevojën që kanë për t'u mbrojtur ato klasifikohen nga një instancë zyrtare ose me porosi të saj.

2) Një porosi lidhur me informacion të klasifikuar

është një kontratë ndërmjet një autoriteti ose një sipërmarrjeje nga shteti i njëres Palë Kontraktuese (porosidhënësi) dhe një sipërmarrjeje nga shteti i Palës tjetër Kontraktuese (kontraktuesi); në kuadër të një marrëveshjeje të këtij lloji, informacione të klasifikuara prej shtetit të porosidhënësit duhet t'i lihen kontraktuesit, të zhvillohen nga kontraktuesi ose të bëhen të shfrytëzueshme për bashkëpunëtorët e tij, të cilët duhet të kryejnë punë në institucionet e porosidhënësit.

2) Për nivelet e klasifikimit të informacionit vlejnë këto përkufizime:

1. Në Republikën e Shqipërisë informacionet e klasifikuara përkufizohen si më poshtë:

a) "Tepër sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme, veçanërisht të rënda sigurisë kombëtare;

b) "Sekret", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme serioze sigurisë kombëtare;

c) "Konfidencial", kur ekspozimi i paautorizuar mund t'i shkaktojë dëme sigurisë kombëtare;

d) "I kufizuar", kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.

2. Në Republikën Federale të Gjermanisë informacionet e klasifikuara përkufizohen si më poshtë:

a) STRENG GEHEIM, kur ekspozimi i këtij informacioni te personat e paautorizuar mund të rrezikojë ekzistencën e Republikës Federale të Gjermanisë ose interesa me rëndësi jetësore të Republikës Federale të Gjermanisë ose të njërit prej landeve të saj;

b) GEHEIM, kur ekspozimi i këtij informacioni te personat e paautorizuar mund të rrezikojë sigurinë e Republikës Federale të Gjermanisë ose të njërit prej landeve të saj ose mund të dëmtojë rëndë interesat e tyre;

c) VS-VERTRAULICH, kur ekspozimi i këtij informacioni te personat e paautorizuar mund të dëmtojë interesat e Republikës Federale të Gjermanisë ose të njërit prej landeve të saj;

d) VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH, kur ekspozimi i këtij informacioni te personat e paautorizuar mund të jetë i disfavorshëm për interesat e Republikës Federale të Gjermanisë ose të njërit prej landeve të saj.

Neni 2

Krahasueshmëria

Palët Kontraktuese vendosin që janë të krahasueshme këto nivele së ruajtjes të informacionit të klasifikuar:

Republika e Shqipërisë

TEPËR SEKRET

SEKRET

KONFIDENCIAL

I KUFIZUAR

Republika Federale e Gjermanisë

STRENG GEHEIM

GEHEIM

VS-VERTRAULICH

VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH

Neni 3

Shenjëzimi

1. Informacionet e klasifikuara të transmetuara shenjëzohen nga autoriteti që mban kompetencën për marrësin e tyre ose me porosi të këtij autoriteti, në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit të krahasueshëm sipas nenit 2.

2. Detyrimi për shenjëzim vlen edhe për informacione të klasifikuara, të cilat krijohen rishtaz në shtetin marrës në lidhje me porositë, që kanë të bëjnë me informacion të klasifikuar, dhe për kopje të prodhuar në shtetin marrës.

3. Me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit të origjinës, nivelet e ruajtjes së informacionit të klasifikuar ndryshohen ose shfuqizohen nga autoriteti kompetent për marrësin e informacionit përkatës të klasifikuar ose me porosi të këtij autoriteti. Autoriteti kompetent i shtetit të origjinës ia njofton autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese qëllimin e tij për të ndryshuar ose shfuqizuar nivelin e klasifikimit të informacionit, gjashtë javë përpara.

Neni 4

Masat e brendshme shtetërore

1. Palët Kontraktuese, në kuadër të dispozitave ligjore të brendshme, marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar ruajtjen e informacioneve të klasifikuara, të cilat krijohen, shkëmbehen ose ruhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Ato u sigurojnë këtyre informacioneve të klasifikuara, më e pakta, ruajtje të barabartë me atë që Pala tjetër Kontraktuese kërkon për informacione të veta të klasifikuara të një shkalle të krahasueshme të ruajtjes së informacionit të klasifikuar.

2. Informacionet e klasifikuara përdoren ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar. Palës tjetër Kontraktuese i ndalohej t'i bëjë të njohura informacionet e klasifikuara, t'i përdorë dhe të lejojë publikimin ose përdorimin e tyre, me përjashtim të rastit kur kjo ndodh për qëllimet dhe me kufizimet eventuale, të cilat janë përcaktuar prej ose me porosi të Palës Kontraktuese të origjinës. Për përjashtim nga ky rregull, Pala e origjinës e informacionit të klasifikuar duhet të ketë dhënë aprovim me shkrim.

3. Në informacionet e klasifikuara duhet t'u lejohet akses vetëm personave, që për shkak të detyrave të tyre plotësojnë kushtin "Njohuri vetëm në rast nevojë" dhe të cilët, me përjashtim të rastit të informacioneve të klasifikuar VS-NUR FÜR DEN DIENST-GEBRAUCH/I KUFIZUAR, janë të autorizuar të kenë akses në informacione të klasifikuara të një niveli të krahasueshëm të ruajtjes së informacionit të klasifikuar. Autorizimi presupozon një kontroll paraprak sigurie, i cili duhet të jetë, më e pakta, aq i rreptë sa ai që kryhet për të mundësuar aksesin në informacione të brendshme shtetërore të klasifikuara të një shkalle të krahasueshme të ruajtjes së informacionit të klasifikuar.

4. Aksesit në informacionet e klasifikuara të nivelit të ruajtjes VS VERTRAU /LICH/KONFIDENCIAL dhe më lart i një personi me shtetësi të vetme të njërës Palë Kontraktuese mundësohet pa miratimin paraprak të Palës Kontraktuese të Origjinës.

5. Kontrollat e sigurisë e shtetasit e Palës Kontraktore, të cilët janë me rezidencë në vendin e vet dhe kanë nevojë atje për akses në informacione të klasifikuara, ndërmerren nga organet e sigurisë kombëtare, përkatësisht prej autoriteteve të ngarkuara të sigurisë ose prej autoriteteve të tjera kompetente.

6. Kontrollat e sigurisë të shtetasve të njërës Palë Kontraktuese, të cilët janë me rezidencë të ligjshme në vendin e Palës tjetër Kontraktuese dhe që aplikojnë atje për një veprimtari që kërkon akses tek informacioni i klasifikuar, kryhen nga autoriteti kompetent i sigurisë i këtij shteti, e paralelisht me këtë, në rast nevojë merren informacione sigurie nga jashtë.

7. Palët Kontraktuese kujdesen brenda territorit të shtetit të tyre për kryerjen e inspektimeve të nevojshme të sigurisë dhe respektimin e kësaj Marrëveshjeje.

8. Për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara të nivelit VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH/I KUFIZUAR, nenet 5 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje nuk gjejnë zbatim.

Neni 5

Dhënia e porosisë lidhur me informacion të klasifikuar

1. Para dhënies së një porosisë lidhur me informacion të klasifikuar, Pala Kontraktuese merr përmes autoritetit të saj kompetent, prej autoritetit kompetent për Palën tjetër Kontraktuese, një dokument sigurie, në mënyrë që të sigurohet, që kontraktuesi i planifikuar i nënshtrohet mbikëqyrjes për ruajtjen e informacionit të klasifikuar nga autoriteti kompetent i vendit të tij dhe që të sigurohet që ai i ka marrë masat e nevojshme të ruajtjes së informacionit të klasifikuar për të zbatuar kontratën. Për rastin kur për një kontraktues nuk zbatohet ende përkujdesja për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, mund të bëhet kërkesë përkatëse.

2. Një dokument sigurie duhet marrë edhe në ato raste, kur një sipërmarrjeje i kërkohet dhënia e një oferte dhe në kuadër të procedurës së tenderimit duhen përcjellë, që para dhënies së kontratës, informacione të klasifikuara.

3. Në rastet e paragrafëve 1 dhe 2 gjen zbatim kjo procedurë:

1. Kërkesat për lëshimin e një dokumenti sigurie për kontraktues nga shteti i Palës tjetër Kontraktuese përmbajnë të dhëna për projektin, si dhe mënyrën, përmasat dhe nivelin e ruajtjes së informacioneve të klasifikuara, të cilat parashikohet t'i lihen për përdorim kontraktuesit ose që krijohen tek ai.

2. Dokumentet e sigurisë, krahas përshkrimit të plotë të ndërmarrjes, adresës së saj postare, emrit të personit përgjegjës për çështjet e sigurisë, numrin e telefonit dhe faksit dhe në rast nevojë edhe adresën e e-mailit, duhet të përmbajë të dhëna veçanërisht për atë, se në ç'masë, si dhe deri në cilin nivel të klasifikimit të informacionit janë marrë masat e sigurimit nga ndërmarrja respektive në bazë të rregullave të

brendshme për ruajtjen e sekretit.

3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën, nëse ndryshon gjendja faktike mbi të cilat lëshohen dokumentet e sigurisë.

4. Shkëmbimi i këtyre njoftimeve midis autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese kryhet në gjuhën e vendit të autoritetit që duhet të marrë njoftimet ose në gjuhën angleze.

5. Dokumentet e sigurisë dhe kërkesat për lëshimin e dokumenteve të sigurisë drejtuar autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të transmetohen me shkrim.

Neni 6

Zbatimi i porosive lidhur me informacion të klasifikuar

1. Porositë, lidhur me informacion të klasifikuar, duhet të përmbajnë një klauzolë të ruajtjes së informacionit të klasifikuar, sipas së cilës kontraktuesi ka detyrimin që të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara në përputhje me rregullat e brendshme për ruajtjen e sekretit.

2. Klauzola e ruajtjes së informacionit të klasifikuar duhet të përfshijë edhe këto përcaktime:

1. përkufizimin e konceptit “Informacione të klasifikuara” dhe të shenjëzimeve të krahasueshme të ruajtjes së informacionit të klasifikuar dhe i nivelit të ruajtjes së informacionit i të dyja Palëve Kontraktuese në përputhje me këtë Marrëveshje;

2. emrat e autoriteteve përkatëse kompetente të Palëve Kontraktuese, të cilët janë të autonizuar të japin aprovimin për dhënien dhe koordinimin e mbrojtjes së informacioneve të klasifikuara, që kanë lidhje me porosinë;

3. kanalet që përdoren për transmetimin e informacioneve të klasifikuara ndërmjet autoriteteve kompetente dhe kontraktuesve pjesëmarrës;

4. procedurat dhe mekanizmat për njoftimin e ndryshimeve, të cilat mund të rezultojnë në lidhje me informacionet e klasifikuara për shkak të ndryshimeve të shenjëzimeve të mbajtjes sekret ose për shkak të skadimit të nevojës për t’i mbrojtur më tej;

5. procedurat për aprovimin e vizitave reciproke ose të aksesit të personelit të kontraktuesve;

6. procedurat për transmetimin e informacioneve të klasifikuara te kontraktuesit, të cilët parashikohen të përdorin dhe ruajnë informacionet në fjalë;

7. kërkesën që kontraktuesi t’ia mundësojë aksesin tek informacioni i klasifikuar vetëm një personi, i cili plotëson kushtin “Njohuri vetëm në rast nevojë” dhe që është i ngarkuar me kryerjen e kontratës ose kontribuon në të, kur personi është verifikuar paraprakisht nga aspekti i sigurisë deri në nivelin përkatës të mbajtjes së sekretit, me përjashtim të rastit të informacioneve të klasifikuara në nivelin VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH/I KUFIZUAR;

8. kërkesën, që një të treti mund t’i jepet akses tek informacioni i klasifikuar ose që përcjellja e këtij informacioni të klasifikuar mund të lejohet vetëm atëherë kur kjo është aprovuar nga qeveria që ka nxjerrë këtë informacion;

9. kërkesën, që kontraktuesi duhet të informojë menjëherë autoritetin e tij kompetent për çdo humbje të ndodhur ose të dyshuar, për një indiskrecion të kryer ose të dyshuar ose për një publikim të paautorizuar të informacioneve të klasifikuara, që kanë lidhje me porosinë.

3. Autoriteti kompetent i porosidhënësit duhet t’i sigurojë Kontraktuesit të Palës tjetër një listë të veçantë të të gjitha informacioneve që duhet të klasifikohen, të përcaktojë nivelin e kërkuar të klasifikimit dhe të bashkëlidhë këtë listë si shtojcë të porosisë, lidhur me informacion të klasifikuar. Gjithashtu, autoriteti kompetent i porosidhënësit duhet ta transmetojë këtë listë ose të kujdeset për transmetimin e saj autoritetit kompetent të kontraktuesit.

4. Autoriteti kompetent i porosidhënësit duhet të sigurojë që kontraktuesi të ketë akses në informacionin e klasifikuar, vetëm kur është lëshuar dokumenti përkatës i sigurisë nga autoriteti kompetent i kontraktuesit.

Neni 7

Transmetimi i informacioneve të klasifikuara

1. Informacionet e klasifikuara të nivelit STRENG GEHEIM/TEPËR SEKRET duhet të transmetohen midis Palëve Kontraktuese vetëm me korrier diplomatik nga një shtet për në shtetin tjetër, në përputhje me rregullat e brendshme për ruajtjen e sekretit.

2. Informacionet e klasifikuara të nivelit VS-VERTRAULICH/KONFIDENCIAL dhe GEHEIM/SERET transportohen nga një shtet për në shtetin tjetër me korrier zyrtar. Organet e sigurisë kombëtare përkatësisht autoritetet e ngarkuara të sigurisë të Palëve Kontraktuese mund të bien dakord për

kanale alternative transmetimi. Marrja në dorëzim e një informacioni të klasifikuar konfirmohet nga autoriteti kompetent ose me porosi të tij.

3. Kur bëhet fjalë për një projekt të përcaktuar, autoritetet kompetente në mënyrë të përgjithshme ose duke vendosur përkufizime - mund të bien dakord që informacionet e klasifikuara në nivelin VS-VERTRAULICH/KONFIDENCIAL dhe GEHEIM/SEKRET të mos transportohen me korrier zyrtar, por në një mënyrë tjetër, në qoftë se përdorimi i korrierit zyrtar do të paraqiste vështirësi të paparashikueshme për transportim ose për kryerjen e porosisë. Në raste të tilla:

1. transportuesi duhet të jetë i pajisur me një autorizim të nivelit të informacionit të klasifikuar që ai transporton;

2. lista e informacioneve të klasifikuara të transmetuara duhet të qëndrojë te Pala Dërguese; një kopje e kësaj liste duhet t'i jepet marrësit për t'ia përcjellë autoritetit kompetent;

3. informacionet e klasifikuara duhet të jenë të paketuara sipas rregullave në fuqi për transportin brenda vendit;

4. dorëzimi i informacioneve të klasifikuara duhet të bëhet kundrejt një dëftese për marrjen në dorëzim;

5. transportuesi duhet të mbajë me vete dokumentin e korrierit, të cilin e kanë lëshuar autoritetet kompetente për institucionin dërgues ose marrës.

4. Për transportimin e një sasive të madhe informacionesh të klasifikuara, transporti, mënyra e transportimit dhe shoqërimi mbrojtës duhet të përcaktohen për çdo rast të veçantë nga autoritetet kompetente në bazë të një plani të detajuar transporti.

5. Informacionet e klasifikuara të nivelit VS-VERTRAULICH/ KONFIDENCIAL dhe më lart nuk lejohet të transmetohen të pashifruara, në rrugë elektronike.

Për shifrimin e informacioneve të klasifikuara të këtij niveli duhet të përdoren vetëm sisteme shifrimi, të lejuara nga autoritetet e sigurisë të Palëve Kontraktuese me miratim të ndërsjellë.

6. Informacionet e klasifikuara të nivelit VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH/I KUFIZUAR mund të transmetohen vetëm duke mbajtur parasysh rregullat e brendshme për ruajtjen e sekretit të marrësi në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet postës ose shërbimeve të tjera të shpërndarjes.

7. Informacionet e klasifikuara të nivelit VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH/I KUFIZUAR mund të transmetohen ose të hapen në rrugë elektronike me anë të pajisjeve që mund të blihen në treg dhe që janë të miratuara nga një autoritet kompetent shtetëror i Palëve Kontraktuese. Një transmetim i pashifruar i informacioneve të klasifikuara të këtij niveli lejohet vetëm atëherë kur ai nuk pengohet nga rregullat e brendshme për ruajtjen e sekretit, kur nuk është në dispozicion një sistem i aprovuar shifrimi dhe kur transmetimi bëhet vetëm nëpërmjet sistemeve të telefonisë fikse dhe kur dërguesi e marrësi kanë rënë dakord më parë për këtë transmetim.

Neni 8

Vizitat

1. Vizitorëve nga territori i shtetit të njëres Palë Kontraktuese u mundësohet akses në informacionet e klasifikuara si dhe institucionet, në të cilat punohet për to, në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese, vetëm me autorizim paraprak të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese që vizitohet. Ai u jepet vetëm personave, që plotësojnë kushtin “Njohuri vetëm në rast nevojë” – dhe që me përjashtim të rastit të informacioneve të klasifikuara në nivelin VS-NUR FÜR DEN DIENSTGEBRAUCH/I KUFIZUAR – janë të autorizuar të kenë akses në informacionet e klasifikuara.

2. Njoftimet për vizita duhet t'i paraqiten autoritetit kompetent të kësaj Pale Kontraktuese në kohën e duhur dhe në përputhje me rregullat e Palës Kontraktuese, në territorin e shtetit të së cilës dëshirojnë të udhëtojnë vizitorët. Autoritetet kompetente i njoftojnë njëri-tjetrit hollësitë e njoftimit të vizitës dhe garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Njoftimet për vizita duhet të paraqiten në gjuhën e vendit që do të vizitohet ose në gjuhën angleze dhe me këto të dhëna:

1. Emri dhe mbiemri, datëlindja dhe vendlindja, si dhe numri i pasaportës ose i letërnjoftimit të vizitorit;

2. Shtetësia e vizitorit;

3. Përshkrimi i funksionit të vizitorit dhe emri i autoritetit ose i instancës që ai përfaqëson;

4. Niveli i autorizimit të vizitorit për akses në informacione të klasifikuara;

5. Qëllimi i vizitës dhe data e parashikuar e vizitës;

6. Të dhëna për instancat, personat e kontaktit dhe institucionet që kërkohen të vizitohen.

Neni 9 **Konsultime**

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese marrin në konsideratë rregullat për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, të cilat vlejnë në territorin e secilës Palë tjetër Kontraktuese.

2. Për të garantuar një bashkëpunim të ngushtë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente konsultohen me njëri-tjetrin me kërkesë të njerit prej këtyre autoriteteve.

Çdo Palë Kontraktuese i jep lejen organit e sigurisë kombëtare përkatësisht autoritetit të ngarkuar të sigurisë të Palës tjetër Kontraktuese ose çdo autoriteti publik të përcaktuar me miratim reciprok, për të bërë vizita në territorin e saj, për të sqaruar me autoritetet e saj të sigurisë metodat dhe pajisjet e saj për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, të cilat i janë vënë asaj në dispozicion nga Pala tjetër Kontraktuese. Çdo Palë Kontraktuese e mbështet këtë autoritet lidhur me konstatimin, nëse informacione të tilla të klasifikuara, të cilat i janë vënë asaj në dispozicion nga Pala tjetër Kontraktuese, mbrohen në një masë të mjaftueshme. Hollësitë e vizitave përcaktohen nga autoritetet kompetente.

Neni 10 **Shkeljet e dispozitave të mbrojtjes reciproke të informacioneve të klasifikuara**

1. Kur nuk mund të përjashtohet një publikim i paautorizuar i informacioneve të klasifikuara, kur kjo dyshohet ose konstatohet, duhet të njoftohet menjëherë Pala tjetër Kontraktuese.

2. Shkeljet e dispozitave për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara hetohen dhe ndiqen nga autoritetet kompetente dhe gjykatat e Palës Kontraktuese, të cilët kanë kompetencën, në bazë të ligjeve të kësaj Pale Kontraktuese. Pala tjetër Kontraktuese duhet t'i mbështesë këto hetime, nëse i kërkohet, dhe duhet të informohet për rezultatin.

Neni 11 **Shpenzimet**

Secila nga Palët Kontraktuese i mbulon vetë shpenzimet që i shkaktohen nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12 **Autoritetet kompetente**

Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën mbi autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13 **Raporti me marrëveshjet ndërkombëtare dhe me memorandumet e mirëkuptimit**

Të gjitha marrëveshjet dhe ujdite që ekzistojnë midis Palëve Kontraktuese ose autoriteteve kompetente për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara nuk preken nga kjo Marrëveshje, për aq kohë sa ato nuk janë në kundërshtim me këtë marrëveshje.

Neni 14 **Dispozitat e fundit**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë njofton me anë të një note verbale Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë se janë plotësuar kushtet e brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Përcaktuese është data e mbërritjes së njoftimit me notë verbale.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pakufizuar kohor.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet pas miratimit me shkrim të të dyja Palëve Kontraktuese. Secila nga Palët Kontraktuese mund të paraqesë në çdo kohë me shkrim kërkesën për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje. Kur njëra nga Palët Kontraktuese paraqet një kërkesë të tillë, Palët Kontraktuese nisin negociatën për ndryshimin e marrëveshjes.

4. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta anulojë këtë Marrëveshje me shkrim në rrugë diplomatike brenda një afati gjashtëmujor. Në rastin e anulimit të kësaj Marrëveshjeje, informacionet e klasifikuara të transmetuara ose të krijuara te kontraktuesi duhet të trajtohen edhe më tej në përputhje me nenin 4.

5. Regjistrimi i kësaj Marrëveshjeje te sekretariati i Kombeve të Bashkuara në bazë të nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara organizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi nga Republika e Shqipërisë. Pala tjetër Kontraktuese informohet duke i njoftuar numrin e regjistrimit të OKB-së që regjistrimi është kryer menjëherë pasi ky është konfirmuar nga sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë, më 18.9.2008 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

LIGJ

Nr.10 044, datë 24.12.2008

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT SHITESË TË “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË AUSTRIËS PËR REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIK PËR REGJISTRIN THEMELETAR TË GJENDJES CIVILE NË SHQIPËRI”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokoli shtesë i “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile në Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5986, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

SHITESË MARRËVESHJEJE NDËRMJET MINISTRISË FEDERALE TË BRENDSHME TË AUSTRIËS DHE MINISTRISË SË BRENDSHME TË SHQIPËRISË

Nënshkruar më 25 qershor 2008

Propozime

Ministria Federale e Brendshme e Austrisë është e kënaqur me ftesën për të ofruar mbështetje për procesin e aplikimit për sistemin e ri të kartave të identitetit dhe pasaportave në Shqipëri.

Bazuar në informacionin që na është dhënë gjatë takimeve të ndryshme me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë dhe kompanisë SAGEM në Tiranë dhe Vjenë, Ministria Federale e Brendshme e Austrisë është e kënaqur të ofrojë dy opsionet e mëposhtme për realizimin e procesit të aplikimit për KID dhe pasaportë të re.

1. Integrimi i të dhënave të nevojshme të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile në Shqipëri në tërheqjen e aplikimeve të SAGEM nëpërmjet ndërfaqes XML

Kosto	250 000 euro
Kohëzgjatja	4 javë
Orët shtesë dhe pajisja e kërkuar e testimit për SAGEM	12 320 euro
Kosto totale	262 320 euro

Më poshtë do të gjeni opsionet e përshkruara me më shumë detaje. Të hënën, më 19 tetor 2008 SAGEM kërkoi një pajisje testimi shtesë nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë për të siguruar projektplanin e propozuar prej tyre. Puna shtesë është llogaritur si më lart. Ministria Federale e Brendshme e Austrisë shpreson që opsionet e propozuara do të përputhen me interesat dhe nevojat tuaja dhe do të jenë të vlefshme për diskutime të mëtejshme.

Vjenë, 20 tetor 2008

Me respekt
Dr. Osvald Kesler
Drejtor i Njësisë Mbështetëse ZMR

SHTESË MARRËVESHJEJE

Të përgjithshme

Kjo shtesë bazohet në rregulla dhe përgjegjësitë e kontratës së nënshkruar më 25 qershor 2008 në Tiranë ndërmjet Ministrisë Federale të Brendshme të Austrisë dhe Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë, në lidhje me realizimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Përshkrimi

Kjo zgjidhje është e bazuar në standarde ndërkombëtare të komunikimit midis aplikimeve apo regjistrave për të shkëmbyer të dhëna. Për këtë opsion Ministria Federale e Brendshme e Austrisë përcakton një ndërfaqe pyetësorë për autoritetet e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Prandaj të gjitha zyrat dhe nëpunësit e regjistrimit duhet të regjistrohen në konceptin e portalit, si dhe të pajisen me certifikatë softueri për të siguruar një lidhje të sigurt me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Ndërfaqja duhet të integrohet në shërbimin e regjistrimit, si dhe nga SAGEM. Pyetësi ka fushat e detyrueshme të mëposhtme:

- Mbiemri;
- Emri;
- Datëlindja ose ID.

Si rezultat vetëm të dhënat e qytetarit që aplikon mund të tërhiqen. Pas kësaj nëpunësi i regjistrimit është në gjendje të vazhdojë me procesin e regjistrimit. Nëse rezultati i përcaktuar konsiston në të dhënat e më shumë se një personi ose adresa është gabim, qytetari duhet të paraqitet në zyrën e gjendjes civile për sqarimin e të dhënave.

Dorëzimet

Ministria Federale e Brendshme e Austrisë duhet të japë dorëzimet e mëposhtme:

- Përkufizimin e ndërfaqes së aplikimit të regjistrimit për SAGEM;
- Trajnimin e grupit të zhvillimit të SAGEM në përdorimin e ndërfaqes dhe mbajtjen e protokollit të komunikimit;
- Zhvillimin e ndërfaqes;
- Testimin dhe shpërndarjen e ndërfaqes për Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile;
- Dokumentimin;
- Testin e pranimit.

Detyrimet e bashkëpunimit të autoritetit kontraktues

Pikat e mëposhtme janë të detyrueshme për autoritetin kontraktues:

- Integrimi i ndërfaqes në aplikimin e regjistrimit të SAGEM;
- Mbledhja dhe integrimi i të dhënave të nëpunësve të regjistrimit në portal;
- Instalimi i certifikatave të softuerit në qendrat e regjistrimit.

Kohëzgjatja, afatet

Për qëllimet e parashikuara, Ministria Federale e Brendshme e Austrisë vlerëson kohëzgjatjen e projektit prej katër javësh duke filluar nga 3 nëntori 2008.

Pagesa

Pagesa për këto shërbime të parashikuara nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë është 262 320 euro, me TVSH të përjashtuar në Shqipëri.

Data e kërkuar

Pagesa për këto shërbime të parashikuara nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë do të bëhet në dy faza të përshkruara si më poshtë:

1. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes 125 000 euro.
2. Pas dorëzimit të shërbimit për SAGEM 137 320 euro.

Numri i llogarisë bankare:	5020009
Kodi Bankar:	60000
Qëllimi:	2110848173005

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.1.2009
Doli nga shtypi më 6.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2008

Çmimi 49 lekë